



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kaçanik  
Municipal of Kaçanik

01Nr. 60/03-14299/24  
Kaçanik, 28.06.2024

## PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **VI (gjashtë)** e rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2024 (Legjislatura e shtatë), mbajtur me 28.06.2024. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës prej 27 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje kur u lexua evidenca, ishin 26 anëtarë. Në ndërkohë arritën anëtari Betim Shala, kështu që konstatohet se pjesëmarrës në këtë mbledhje ishin 27 anëtarë.

Nga Ekzekutivit i Komunës në mbledhje apo në pjesë të mbledhjes, morën pjesë: Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, Nënkryetari i Komunës-Sabedin Vishi, Drejtorët e drejtorive: Bahri Selimi-DBF, Ramadush Osmani-DSHPE, Qamil Stagova- DUKMM, Zahir Doda-DA, Suhad Dullovi- DBPZHR, Pranvera Loku-Zharku-DZHET, Dardana Tafili-Dauti-DAP, ndërkaq nga zyrtarët: Bejtulla Dalloshi, Makfire Malsiu, Mavije Murseli.

Nga strukturat vendore mbledhja monitorohet përmes Teleprezencës nga Vjosa Ahmetaj-zyrtare në MAPL. Mbledhja ka transmetim të drejtpërdrejtë.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Murseli- Kryesues i Kuvendit  
Procesmbajtës, Makfire Malsiu - Zyrtare e lartë për punë të KK.

**Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Murseli:** Të nderuar pjesëmarrës, së pari iu përshëndes të gjithëve, iu dëshiroj mirëseardhje, konstatoj kuorumin, kushte pune me u mbajt mbledhja ka, e hapi mbledhjen e VI (gjashtë) të rregullt të Kuvendit të Komunës, data 28.06.2024, me këtë:

### REND PUNE

1. Betimi Solemn i anëtarit të zgjedhur të Kuvendit të Komunës nga subjekti politik, Partia Demokratike e Kosovës, Lirije Dema;
2. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
3. Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës (KABK) së Kaçanikut 2025-2027;
4. Propozim Vendim për rialokimin e mjeteve sipas buxhetit të vitit 2024;
5. Propozim Vendim për transferin e mjeteve sipas buxhetit të vitit 2024;
6. Propozim Vendim për Ndryshim Plotësimin e Vendimit 01 Nr. 06-350-9402/2016 të datës 30.03.2016 për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik ZK në Kaçanik të Vjetër, për ndërtimin e Impiantit, për trajtimin e ujërave të zeza;
7. Propozim Vendim Paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite;
8. Propozim Vendim për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite, të pronës së paluajtshme të komunës;

9. Propozim Vendim për realizimin e një vizite zyrtare studimore e anëtarëve të Kuvendit dhe të Ekzekutivit të komunës Kaçanik, jashtë vendit - në një nga vendet e rajonit;
10. Propozim Vendim për Ndryshim Plotësimin e Vendimit 01 Nr. 60/01-38152/21 të datës 29.12.2021 për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa;
11. Propozim Vendim për miratimin e Raportit përfundimtar Nr. 08-320/01-11894/24 të komisionit komunal për vlerësimin e dëmeve nga reshjet e breshërit në territorin e komunës së Kaçanikut, në Llanishtë dhe Kotlinë;
12. Rekomandimi i komisionit vlerësues 01Nr. 104/02-11398/24 -për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës për 99 vite, në Zonën Kadastrale Doganaj, ofertuesit ROYAL BENVERAGE LL.C;
13. Rekomandimi i komisionit vlerësues 01Nr. 104/02-11401/24 -për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës për 99 vite, në Zonën Kadastrale Koxhaj, ofertuesit X Pro Inovation LLC;
14. Rekomandimi i komisionit vlerësues 01Nr. 104/02-11400/24 -për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës për 99 vite, në Zonën Kadastrale Koxhaj, ofertuesit Suad Koxha;
15. Rekomandimi i komisionit vlerësues 01Nr. 104/02-11403/24 -për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës për 99 vite, në Zonën Kadastrale Kotlinë, ofertuesit ECO-EXCLUSIV Sh.P.K.

Rendi i punës u shtrua në votim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës

#### **APROVOJ**

#### **Rendin e punës në përbërje prej 15 pikave.**

1. Betimi Solemn i anëtarit të zgjedhur të Kuvendit të Komunës nga subjekti politik, Partia Demokratike e Kosovës, Lirije Dema;

**Kryesuesi i Kuvendit:** E ftoj anëtarin e zgjedhur nga PDK, Lirije Dema, të ngritët në këmbë dhe të lexoj deklaratën e Betimit Solemn, ndërkaq në shenjë respekti për betimin e anëtarit të KK, i ftoj të gjithë të pranishmit të ngritën në këmbë.

**znj. Lirije Dema-** Fillimisht i përshëndeti të gjithë të pranishmit, e lexoj tekstin e Betimit Solemn si në nenin 35.5 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, si vijon: “Betohem (ose deklaroj solemnisht) se do t’i kryej me nder, besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do ti ushtroj autorizimet e mia si anëtar i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë”. Deklarata e Betimit Solemn u nënshkrua nga Lirije Shehu / Lënda: 01Nr.60/02-14974/24.

**Kryesuesi i Kuvendit:** E falënderoj Lirije Dema për Betimin e dhënë, i dëshiroj suksese dhe punë të mbarë në aktivitetin e KK, ndërkaq konstatoj;

**Ndryshim Plotësimet e përbërjes së Kuvendit të Komunës të Legjislaturës së shtatë (7) të KK, të zgjedhur me 17 Tetor 2021/ Lënda: 01Nr. 104/02-14973/24.**

Në bazë të Vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ( KQZ) Nr. 01/966/2024 të datës 18.06.2024 pranuar me 19.06.2024 me numër të protokollit të komunës 01Nr. 060/01-14334/24, anëtari i dorëhequr nga PDK Fitore Vishi, zëvendësohet me kandidatin e radhës nga subjekti politik i PDK, Lirije Dema. znj. Lirije Dema nga data e dhënies së Betimit dhe nënshkrimit të Deklaratës soleme, realizon të gjitha të drejtat dhe detyrat si anëtarët tjerë të Kuvendit të Komunës, përfshirë edhe kompensimin, ndërkaq znj. Fitore Vishi, pushon të jetë

anëtar i KK sipas dispozitave të nenit 37.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 me vendim të KQZ Nr. 01/966/2024 të datës 18.06.2024.

Të gjithë anëtarët e KK që e morën fjalën për pikat në vijim, fillimisht e uruan Lirije Dema, i dëshiruan shëndet dhe suksese në aktivitetin e punës së KK. Gjithashtu edhe anëtarët e Ekzekutivit, duke filluar nga Kryetari i Komunës, të gjithë që morën fjalën, paraprakisht e uruan anëtarin e re të KK, Lirije Dema, i uruan punë të mbarë, shëndet dhe suksese.

2. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;

Procesverbali i mbledhjes së kaluar u aprovua me një votë Abstenim, Kadrije Lika-Troni, për arsye se nuk ka qenë pjesë e procesit. Prezentë 27. Në sajë të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës

### **Aprovoj**

**Procesverbalin e mbledhjes së V (pestë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës Kaçanik, të datës 31.05.2024 / Lënda: 01Nr. 60/01-11877/24.**

**Kryesuesi i Kuvendit:** Kalojmë në pozicionin e Pyetjeve dhe Kërkesave:

### **Pyetje dhe Kërkesa**

**znj. Ardita Rrahmani:** 1. Mësimi në shkollën SHFMU “Emin Duraku” në vitin e kaluar filloj me vonesë, për shkak të punimeve në atë objekt, pse duhet me i detyruar me mbajtur mësim shtesë në këto temperatura të larta, duke rrezikuar shëndetin e fëmijëve dhe arsimtarëve, me javë të tjera zëvendësuese. Në mbledhjen e mbajtur me herët me kolektivin, janë njoftuar se nuk do të ketë shtyrje të mësimin në vitin akademik. Duke kuptuar shumë mirë qëllimin e kompensimit e orëve të humbura, mendoj se transparenca karshi mësimdhënësve do ishte me mirë të bëhej në kohë reale.

2. Rruga Dëshmorët e Kombit, “Malsor Dashi” të varrezat e dëshmorëve Stagovë, verës është e qarkullueshme dhe e rrezikshme për qytetarët që frekuentojnë në atë pjesë. Përpos mungesës së trotuarit, shpejtësia që zhvillohet në atë pjesë, rrezikon direkt jetën e qytetarëve, për ecje atraktive në atë pjesë.

3. Kur flas për shpejtësinë e veturave, pengesat në rrugë, janë të nevojshme në rrugën “Qamil Ilazi” dhe në Bulevardin” Ismail Raka”. Të rruga “Ismail Raka” përfshirë edhe pjesën të ndërtesa P+8, shprehi shqetësimin e qytetarëve që jetojnë në atë pjesë, për zhurmën që krijohet nga aparatet e boksit që shërbejnë edhe pas orës 12:00. Aparatet e boksit përpos që zënë hapësira publike, krijojnë edhe zhurmë. Mendoj se qytetarët duhet të jenë rehat në shtëpitë e tyre nga zhurma.

4. Çka po ndodhë me parkingun publik dhe të stërmbushur, prish e ndreq nga komuna dhe ky pushtet, të ndërtesa 8 katesh. Kam një kërkesë, si qytetare e këtij vendi, bëni rregulla dhe jepni leje në harmoni me kërkesat dhe interesin publik të qytetarëve të këtij vendi.

**znj. Kadrije Lika Troni:** 1. Të Bulevardi “Ismail Raka” A është përfunduar krejt projekti dhe çfarë plani keni në lidhje me vazot prej betoni, a janë vetëm për dekor, apo do të mbjellin ndonjë lloj lule?

2. Për arsye personale, në mbledhjen e fundit nuk kam marrë pjesë në mbledhje, po i adresoj një shqetësim të prindërve për nxënësit e shkollës fillore “Emin Duraku”. Përse nxënësit e klasës së 6 të kësaj shkolle, detyrohet të rrinë vetëm në shkollë, për me pastruar klasën, marrë parasysh se për moshën e tyre, kjo paraqet shqetësim të prindërit, se përderisa ekziston stafi teknik i shkollës, pse me u marrë fëmijët e shkollës me pastrim. Rreziku është edhe me i madh me ndenjuri ata nxënës në shkollë me pastruar pa asnjë mbikëqyrës. Nëse ke mundësi drejtor me na informuar, kjo iniciativë a është e rregulluar si rend shtëpiak, me rregullore të shkollës

dhe a duhet kjo iniciativë të jetë në koordinim me prindërit e nxënësve, apo është ndëshkim vetëm për nxënësit?

**z. Naim Beça:** E kam një shqetësim për edukatorët e Çerdhes së fëmijëve për pushimin e edukatorëve që po e marrin gjatë verës 6 javë. Në asnjë komunë kjo nuk ndodhë. A ka mundësi me u shkurtuar ky pushim, se ka fëmijë në çerdhe dhe asnjë prindër nuk ka pushim vjetor 6 javë? Duhet me bërë një zgjidhje, se nuk është në rregull fëmijët e çerdhes me ndenjuri në shtëpi 6 javë.

**z. Bashkim Luma:** E përsërisë një kërkesë për DGJF, lidhur me projektet e f. Gllloboçicë dhe shpenzimet e drurit dhe llojit të drurit, diferenca e shpenzimeve në mes viteve, se është e madhe. Një përgjigje është dashur të me ofrohet para 2 mbledhjeve.

**z. Agim Çaka:** 1. Sheshi i qytetit, a është i përfunduar, apo është lëshuar para kohe?

2. Ndriçimi publik të halla e sporteve të fusha sportive, a është i instaluar, se nuk po funksionon, ndërkaq është shumë i nevojshëm, sidomos në sezonin e verës, se fusha mund të shfrytëzohet gjatë natës, për shkak të vapës.

**znj. Ernesta Krasniqi:** Po e ndaj një shqetësim të banorëve të f. Kaçanik i Vjetër dhe Bergracë, për problemin e mungesës së ujit të pijes, apo ujit me shtypje të vogël. Numri i banorëve është rritur, kërkoj të di: A do të merrni veprime të nevojshme për zgjidhjen e problemit të ujit të pijes për këto dy fshatra?

**z. Rrustem Zenuni:** Gjatë mbledhjes të muajit prill, ia ka adresuar një kërkesë Ekzekutivi i Komunës, Ministrisë së Infrastrukturës për shpalljen e thirrjes publike për komunat, që komunat me konkurruar me projekte. Me intereson të di: A është përfshirë komuna e Kaçanikut në ndonjë projekt sipas thirrjes publike, a ka përfituar komuna ndonjë projekt nga thirrja publike?

**z. Naim Beça:** Një plotësim desha me bërë: A ka të drejtë komuna e Kaçanikut me iu dhënë ujë, komunave tjera., kur dihet se ne si komunë nuk kemi ujë të mjaftueshëm për veti. E kemi fshatrat që u përmenden se nuk kanë ujë të pijes, ndërkaq uji i pijes ka shkuar në Verban. Çështja e ujit të pijes është jetike, qytetarëve të komunës iu intereson qysh me pasur ujë të mjaftueshëm të pijes. Çështja e ujit të pijes, duhet me debatuar në një mbledhje të KK.

Kërkoj me bërë pauzë, pas shqyrtimit të gjysmës së pikave të rendit të punës.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Ne nuk menaxhojmë me ujësjellësin si komunë, është kompania "Bifurkacioni" që e menaxhon ujin, atje duhet me i ngritur këto shqetësime. Çështja është shumë me vend, nëse pajtoheni edhe ju, e debatojmë këtë çështje në një mbledhje të KK- në mbledhjen vijuese. Për gjendjen e ujit të pijes në komunën e Kaçanikut, mundemi me ftuar edhe kryeshefin e kompanisë "Bifurkacioni" me marrë pjesë në mbledhje. Si po shihet të gjithë po pajtohemi që, çështja e ujit të pijes në komunën e Kaçanikut me u debatua në mbledhjen vijuese. Për pauzë të KK, do të bëjmë pasi të përfundojnë gjysma e pikëve të rendit të punës.

**znj. Kadrije Lika Troni:** Nëse me keni kuptuar, unë e pata fjalën për vazot e zbrazura të Bulevardi "Ismail Raka" e jo të sheshi i qytetit.

**znj. Ardita Rrahmani:** Një përgjigje të cilën ma keni dërguar drejtor- drejtori i DUKMM, Qamil Stagova, lidhur me ndërtimet, bazën ligjore, neni 18 të ligjit për ndërtim, kam një pyetje prej qytetarëve: A lejohet ndërtimet në lartësi në distancë 50 metra si banesa e madhe? Unë mendoj se mundem, por me pasur me të qartë për ju. Kërkoj përgjigja të me jepet tani.

Kjo përgjigje është vazhdimësi e përgjigjes së muajit të kaluar, që përgjigjen e kam marrë para 3 ditëve, dhe nuk është në rregull mos me lejuar drejtorin me dhënë përgjigje.

**znj. Kadrije Lika\_Troni:** Kryesues nuk duhet me përdorë standarde të dyfishta.

**z. Agim Çaka:** Ka përgjigje që mundet të jepet aty për aty, sepse nuk ka nevojë për informata shtesë.

**znj. Ardita Rrahmani:** Nuk duhet me përdorë standarde të dyfishta, dikujt me i dhënë përgjigje këtu, dikujt jo.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Unë rregulloren e di, këto rregulla nuk i kam krijuar unë, i kam gjetur, Përgjigja jepet në mbledhjen vijuese, se nuk e kemi praktikë me dhënë përgjigje tani për tani. Kalojmë në pikat vijuese:

### 3. Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës (KABK) së Kaçanikut 2025-2027;

E hapi diskutimin:

**z. Agim Mani:** KABK është një dokument që duhet të specifikoj qartë, vizionin, qëllimin dhe realizimin. Ky dokument për fat të keq është sjellë shabllon, përsëritet prej vitit në vit. Kjo tregon mungesë të vizionit dhe nevojave reale të qytetarëve të komunës së Kaçanikut. Janë përsëritur projektet kapitale si në vitet tjera, të cilat figurojnë vetëm si numra, e jo si obligim dhe planifikim i projekteve. Nëse bëjmë krahasime të IK me projektet, janë shënuar si tituj dhe asnjëherë nuk janë realizuar, edhe pse këto projekte është dashur me u realizuar me herët. Nëse flasim për projektet kapitale, mungon transparenca të mjetet për financim të projekteve. Të mjetet për financim të projekteve, janë paraparë mbi 1 milion euro për vitet 2025-2027, mjetet nuk janë të specifikuar. A mundesh dikush me kuptuar për çfarë projektësh bëhet fjalë? Nëse drejtori mundet me na sqaruar për secilin projekt veç e veç, përndryshe kjo është jo transparente. Të Bujqësia, vizioni i juaj është zhvillimi ekonomik në bujqësi. Një ndër prioritet kryesore në komunën e Kaçanikut duhet të jetë bujqësia, ndërsa buxheti i ndarë është i vogël për bujqësi, në raport me përqindjen e qytetarëve që merren me këtë fushë. Nuk ka komuna jonë Strategji si me u zhvilluar bujqësia në komunën tonë, nuk ka politika që me ndihmuar fermerët e vegjël. Dihet si janë ndarë subvencionet në bujqësi në vitin e kaluar, moto kultivatorët janë ndarë militantëve, në vend se me iu ndarë buqëve. Kjo tregon për nepotizëm, Duhet të krijohet një vizion dhe mision i qartë për politikën në bujqësi, që Kaçaniku të jetë një vend modern, me zhvillim rural në bujqësi, me kapacitet përpunues të prodhimeve bujqësore. Duhet të rritet përkrahja e subvencioneve në bujqësi, garanci dhe transparenca e plotë. Fermerëve t'iu sigurohet tregu, sepse e dimë në çfarë kushtesh i shesin produktet e tyre. Buxheti i ndarë, nuk siguron zhvillim në bujqësi. Kërkojmë që të ndihmohen fermerët me subvencione me mjete bujqësore. Nuk janë subvencionuar fermerët e vegjël që nuk përfitojnë subvencione nga ministria, ata që kanë me pak se 5 krerë gjedhe. Duhet të krijohet një shumë e veçantë e kompensimet për ngordhjen e kafshëve nga sëmundjet e ndryshme, dëmtimet nga kafshët e egra, etj. Të Zhvillimi ekonomik dhe të planifikimi urban, janë ndarë pak mjete me këtë KABK. Të DKRS për 3 vite, janë ndarë 210,000€. Është paraparë ndërtimi i rrugës të Xhamia e dëshmorëve, 100m nuk e di pse nuk kryhet ajo rrugë. Të rregullimi i ndriçimit publik janë 125 mijë euro, 195 mijë për tre vite, kërkoj që të ketë mbikëqyrje ndriçimi publik, se nuk punojnë shumica e dritave. Në projekte të ndryshme infrastrukturore, nuk keni ndarë mjete, 500 mijë euro 2026-2027. Të rregullimi i rrugës: Runjevë-Stagovë-Kaçanik i Vjetër, 80 mijë euro janë ndarë në vitin 2025, ndërkaq nuk janë paraparë mjete në vitin 2026 dhe 2027. Me këtë shumë të mjeteve nuk mundet me u shtrua ajo rrugë. Me e rëndësishme ka qenë ndërtimi i urës se

është shumë e ngushtë, ura është dëmtuar gjatë rregullimit të hekurudhës, është nevojë urgjente me u rregulluar ura, ju nuk e keni paraparë këtë projekt, keni paraparë ndërtimin e urave mbi lumin Lepenc. Cilat janë ato ura? Të ndërtimi i terreneve sportive, 50 mijë euro, nuk e di çka mundet me u bërë me këto mjete?

**z. Bahri Selimi:** Projekti i rregullimit të rrugës Runjevë-Stagovë-Kaçanik i Vjetër, përfundon në vitin 2026, nuk ka nevojë me u ndarë me tepër mjete.

**z. Brahim Imishti:** Të çështja e subvencioneve në bujqësi, që u tha se janë ndarë militantëve të PDK, unë njoh përfitues të militantëve të LVV që kanë përfituar nga subvencionet, mundem me ua përmendur me emra.

**z. Agim Mani:** Unë kam militant nga LVV që janë bujq dhe nuk kanë përfituar nga subvencionet në bujqësi. Kam argumente që subvencionet që janë dhënë në bujqësi, nuk janë mbikëqyrë nga Ekzekutivi.

**z. Rrustem Zenuni:** Unë vëllain e kam që ka aplikuar për subvencione në bujqësi, nuk ka përfituar.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Janë kriteret që janë vendosur për ndarje të subvencioneve, drejtori është këtu, lista e përfituesve është publike.

**znj. Ardita Rrahmani:** Nuk është me rregullore as debati në mes anëtarëve të KK me iu kthyer përgjigje. Të KABK, i kemi kontribuar si LDK edhe debatit me qytetarë me pjesëmarrje dhe në debat dhe në KPF. Shqetësimet të cilat u dhanë atë ditë nga përfaqësuesit e fshatrave, nuk i keni ndryshuar në KABK e më na i dërguar këtu, atëherë ku është qëllimi i debatit?

**znj. Kadrije Lika-Troni:** Në KABK e pyes drejtorin a janë paraparë mjete për objektet banesore që nuk kanë ashensor, marrë parasysh se ka njerëz që përballen me probleme të natyrave të ndryshme shëndetësore, mungesa e ashensorëve ua vështirëson edhe me tepër shëndetin e tyre.

**z. Bashkim Luma:** Pyetje për drejtorin: Sa është shuma buxhetore 2022-2023 e mjeteve të cilat janë shpenzuar në bujqësi?

**Kryesuesi i Kuvendit:** Është cekur si shifër në raport, tani nuk e kemi raportin për me ditur, sqarimin e jep drejtori.

**z. Agim Mani:** Po lidhem të debatet publike, mospjesëmarrja e qytetarëve është shqetësuese. Është dashur me sjellë procesverbalin e mbledhjes, me i ditur kërkesat e qytetarëve, me i analizuar. Mospjesëmarrja e qytetarëve mendoj unë, vjen për shkakun se, është e pavlerë pjesëmarrja e tyre, sepse nuk janë futur projektet që janë dalë nga debatet publike.

**z. Rrustem Zenuni:** Nuk kam marrë pjesë në Debate publike për KABK për shkak të angazhimeve tjera. Qytetarët kanë edhe angazhime tjera, për shkak të orarit se nuk iu përgjigjet me marrë pjesë në debate. Kërkesat mund të jenë të shumta, ndërkaq krejt këto projekte që janë realizuar, janë në bazë të nevojave të komuniteteve, se kërkesat mund të jenë të ndryshme. Takimet e qytetarëve një pjesë janë e organizuar një pjesë jo, unë e marrë shqetësimin e tyre dhe i përcjelli tek organet përgjegjëse, kjo i shërben edhe KABK. Nevojat e qytetarëve kanë qenë planifikime dhe do të jenë, pavarësisht a jam unë apo jo, institucioni është përgjegjës. Duhet me pasur mirëkuptim, diku intervenohet me herët, diku me vonë, mundësitë tona janë këto.

**znj. Ardita Rrahmani:** Rregulloni orarin. E vetmja mundësi që qytetari ma ka besuar është kjo karrigë. Unë e kam pa në faqe që është thirrur diskutimi publik. Ku i keni bërë ato pyetje Rrustem?

**Kryesuesi i Kuvendit:** Kur ne jemi organizues të debatit publik, duhet me qenë pjesëmarrës. Është hera e parë që KK ka mbajtur debat publik për KABK, hera tjera kemi me qenë me të përgatitur. E kemi ftuar këtë takim se po e kërkon KDI. Ne jemi të obliguar pas 1 shtatorit, pasi të marrim draftin e buxhetit, të mbajmë debat publik, para miratimit të buxhetit në KK.

**z. Agim Mani:** Të Debatet publike, nuk merren parasysh kërkesat. Administratori i f. Stagovë, në vitin 2023 e ka dërguar listën për projekte kapitale, asnjë projekt nuk është realizuar nga ato që iu ka dhënë fshati prioritet. Cila është arsyeja me marrë pjesë në debate publike?

**z. Naim Beça:** Një email që e kam pranuar për KBAK, shkruan sporti dhe rekreacioni, në vitin 2016 ka filluar stadiumi në Stagovë, ai është funksional, ka kapacitet mbi 8 mijë ulëse. Është e pamundur aty 8 mijë ulëse se nuk janë kushtet. Shënohet se ka hapësira ndihmës, ndërkaq projekti nuk është përfunduar në tërësi. Projekti është në proces, se janë ndërprerë punimet. A e ka pasur kod 5,000€ për stadium që keni paraqitur në tabelarin 6? Edhe sa mjete duhen për këtë projekt?

**Kryesuesi i Kuvendit:** Përgjigjet i jep drejtori.

**znj. Ardita Rrahmani:** Përgjigjet të jepen me shkrim.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Jemi të çështja konkrete, e jo të pyetjet dhe kërkesat.

**znj. Ernesta Krasniqi:** Kam një propozim konkret për drejtorin: Shuma e mjeteve për bursa për studentë të dalluar duhet të rritet, për shkak se shuma është jo e mjaftueshme në raport me shpenzimet që i kanë studentët. Gjithashtu duhet të rritet numri i studentëve që përfitojnë bursë, se është rritur buxheti i komunës.

**znj. Arta Avdiu:** Në KBAK është mirë me parashikuar ndarjen e mjeteve për fëmijë të porsalindur, pasi jemi prej komunave që nuk i kemi mbështetur. Buxheti dihet sa është, por se paku me ndarë një shumë minimale, qoftë edhe 100€ për çdo fëmijë të posa lindur.

**z. Agim Çaka:** Të KBAK janë përfshirë shumë projekte strategjike me prioritet, shqetësimi im është mungesa e PZHK dhe e Hartave Zonale, se nuk mundem me u realizuar këto projekte, pa i pasur këto dy dokumente. Nuk e di komunat tjera a i kanë të miratuara këto dy dokumente. Ne si komunë nuk mundemi me ecur përpara pa i pasur këto dy dokumente, se nuk mundem me u bërë projekte pa i pasur planet. Duhet me iu dhënë rëndësi shumë paraprakisht këtyre dy dokumenteve, që me vazhduar me projekte si në KBAK. Çështjet tjera të përfshira në KBAK, që nuk kanë lidhje me PZHK janë çështje tjetër, por shumica e projekteve kanë të bëjnë me zhvillim ekonomik, turizëm që duhet të jenë me PZHK.

**Kryetari i Komunës-Besim Ilazi:** Po ndërlidhem me shqetësimet për pjesën e debateve, çështjet tjera që u ngritën, sigurisht përgjigjet drejtori. Është shqetësuese çështja e debateve, ende nuk po arrijmë me gjetur formën, jemi në konsulencë me DEMOS, sikurse komunat tjera, por edhe ata ende nuk kanë mundur me gjetur formën e duhur. Një arsye, mendoj është se: Zyra ime është e hapur çdo ditë për qytetarë, aty vijnë dhe i paraqesin shqetësimet. E dyta, janë administratorët e komuniteteve janë të thirrur me i ngritur shqetësimet e komuniteteve, andaj unë i shoh të arsyeshme konsultimet me administratorët e fshatrave. Unë mundem me i thirrur e me i sjellë qytetarët këtu-30-40 e me mbushur sallën, por nuk mendoj se është zgjidhja. Çështja është me ardhur me vullnetin e vet këtu dhe me i ngritur shqetësimet. Këtë problem e

kanë edhe komunat tjera. Të bujqësia, duhet me u krenuar se janë bërë investime në bujqësi. Në fushatë zgjedhore i kam premtuar 300 mijë euro, 700 mijë janë, duke u përkrahur edhe nga OJQ e ndryshme, siç e kemi tani rastin për përkrahje me 100 sera. Kur jemi të bujqësia, në 6 vitet e fundit mund të themi se janë ndarë 900 sera. Ku me pasur atë fat me thithë investime drejtoritë tjera sikurse bujqësia. Të kriteret, mundeni me pasur pakënaqësi, ato i ka përcaktuar dikush tjetër.

**z. Bahri Selimi:** Buxheti për vitin 2025 do të jetë mbi 12 milion e 592 mijë euro. Kemi ngritje të GQ 470 mijë, GA 230, 31 mijë euro zvogëlim të GSH. Në total financimi qeveritar në raport me vitin 2024 është 5.3%. të HVK i kemi mbi 26 mijë euro me tepër planifikim. Në total buxheti ka ngritje për 5.3%. kjo ngritje nuk mjafton as për mbulimin e pagave shtesë. Pagat do të jeni diku 7 milion euro, 3.2 milion euro do të jenë IK -për 25% me tepër apo 180 mijë euro. Të pyetja e Agimit, KBAK është planifikim afatmesëm 3 vjeçar për dallim nga buxheti që ndahet për vite. Të bashkëfinancimi i projekteve, ne jemi në fazën fillestare, deri me miratimin e buxhetit në shtator, do t'i specifikojmë projektet duke dëgjuar edhe zërin e qytetarëve. Bashkëfinancimin e projekteve nuk mundemi me ditur saktësisht se nuk i dimë sa kanë me investuar ministrinë e linjës apo sa kemi me pasur donacione. Kemi qenë përfitues të GP në bazë të raportit të mirë të auditorit për pasqyrat financiare, bazuar në performancën e komunës. Jemi përfitues të GP 500 mijë euro në saje të realizimit të projekteve, për menaxhimin e buxhetit, realizimit, kontrollit financiar, që janë vlerësuar nga ministria. Të bujqësia, vizioni i bujqësisë kur ka qenë vizioni i ekzekutivit është paraqitur nga subjekti ynë, i përmendi kryetari, nuk po e zgjas me tepër. Të rruga e "Xhamisë së Dëshmorëve" në mungesë të buxhetit ka ngelë, besoj drejtori i DSHPE do të përmend projektet që mundet me i elaboruar. Të rruga Runjevë-Stagovë- Kaçanik i Vjetër, janë 80 mijë euro, është projekt i nevojshëm, është në fazën e dytë të tenderimit. Të Ardita Rrahmani, e përgëzojmë për pjesëmarrje e kontribut si e vetmja anëtare e KK, nuk mundem me thënë që çdo kërkesë e administratorit apo e anëtarit të KK do të futet në buxhet, por ju epët prioritet sipas mundësive buxhetore.

**znj. Ardita Rrahmani:** Edhe Fatmir Bunjaku ka qenë pjesë e debatit. Rruga për Stagovë, drejtor ka që 3 vite që përsëritet si kërkesë. Zgjerimi i asaj rrugë nuk është vetëm për këmbësor, por krijohet mundësia e zgjerimit të qytetit në atë pjesë, se nuk ka alternativë tjetër.

**znj. Kadrije Lika-Troni:** Unë kam pasur kërkesë direkte të rruga "Vëllezërit Çaka, është një person hendikep, e ka të pamundur me zbritur poshtë, shkaku i një ashensori.

**z. Bahri Selimi:** Po edhe Fatmiri ka marrë pjesë në debat publik. Rruga e Stagovës, çështja është e kontesteve të pronave, si ekzekutiv e kemi këtë shqetësim. Të pyetja e Kadrijes, nuk kemi pasur ndonjë kërkesë, jemi në proces të buxhetit, shumë objekte nuk kanë ashensor, nuk është që nuk kemi investuar në objekte banesore edhe pa planifikim. Të pyetja e Naimit, për Stadiumin, nuk kemi mjete në listë të projekte kapitale, nuk kemi shumë të ndarë, presim nga ministria ndonjë investim. Të pyetja e Ernesta, edhe ne dëshirojmë me rritur shumën dhe numrin e studentëve bursist, por çështja është se nuk po kemi mundësi me i ngritur subvencionet për shkak të pagave dhe nevojave tjera, do të analizojmë këtë çështje me drejtorin. Të pyetja e Artës është njëjtë, çështja e buxhetit. Të pyetja e Agim Çaka, është e vërtetë se nuk kemi PZHK dhe Harta zonale, vazhdojnë me ngecur investimet në mungesë të PZHK, vazhdojnë arsyetimet, ministri komunë dhe anasjelltas.

**z. Agim Mani:** Diskutimet publike kryetari i bëri të parëndësishëm, duke thënë se qytetarët vinë i zgjidhin problemet në zyrën time. Të bujqësia, e keni në prioritet investimet në bujqësi, ndërkaq të projektet kapitale në bujqësi, i keni ndarë në vitin 2025 vetëm 50 mijë euro. Si mundeni me ia rregulluar infrastrukturën bujqësisë me këtë shumë të mjeteve?



**Kryetari i Komunës:** Për subvencione në bujqësi është fjala.

**z. Bahri Selimi:** Orientimin me të madh për linjën direkt të fermerëve e kemi të subvencionet, sera, moto-kultivator. Të projektet kapitale, ne i lëmë për kanale të ujitjes, do të mendojmë për rrugë fushore në të ardhmen. Infrastruktura rrugore bëhet përmes drejtorive tjera, si DUKMM, Kanalet e ujitjes janë të shërbimet publike dhe aty ka progres të madh.

**z. Bashkim Luma:** Subvencionet në bujqësi 518, 454 euro, nëse i ndajmë në përqindje, nga participimet e qytetarëve, OJQ, e shohim se as 50% nuk janë subvencione të komunës. Nëse e shikojmë vitet 2022-2024, edhe pse komuna e ka prioritet bujqësinë, për dy viteve i bien 22-23 milion përafërsisht subvencione në bujqësi, ndërkaq nuk ka investuar komuna, edhe pse e ka prioritet bujqësinë.

**Kryetari i Komunës:** Unë e potencova se në fushatë i kam premtuar 300 mijë euro subvencione, tani i kemi 600 mijë, nuk përmenda shifra tjera.

**znj. Ernesta Krasniqi:** Kërkoj që mjetet për bursa, studentëve, t'iu shpërndahen gjatë në çdo muaj studimeve, se kanë nevojë, e jo pasi të përfundojnë semestrin.

**Kryetari i Komunës:** Mundem me ndryshuar diçka në këtë drejtim, se është krijuar një rregull me u ndarë në atë formë që sa vjet. Ne mundemi me ndryshuar formën, por çështja është si me rritur numrin e bursave.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutime të tjera nuk ka, KBAK e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta 13 Për, Kundër 7 nga LVV. Prezentë 25. Nuk janë: Florina Lika Vishi dhe Raif Kasa. Në sajë të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### VENDIM

**Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës (KABK) së Kaçanikut 2025-2027 dhe e njëjta lëshohet në procedurë të diskutimit publik me qytetarë/ Lënda: 01Nr. 400/01-14151/24.**

4. Propozim Vendim për rialokimin e mjeteve sipas buxhetit të vitit 2024;

**Kryesuesi i Kuvendit:** E hapi diskutimin:

**z. Agim Mani:** Ka shumë propozim vendime të kësaj natyre të cilat i keni sjellë për miratim. Me ligj është e lejuara rialokimi i mjeteve të ngelura nga projektet, por jo kështu qysh keni kërkuar, ende pa filluar projekti, mjetet rialokohen, kjo nuk është e drejtë, se mundem me u rialokuar një pjesë e mjeteve 10 apo 15% e jo mjetet e krejt projektit. Kjo tregon për keq planifikim, janë 420 mijë euro që kërkohen me u rialokuar, kjo është shqetësuese si i ka planifikuar ekzekutivi dhe si po i realizon. Është gabim nga ekzekutivi që fillimisht nuk është bërë studimi i fizibilitetit, po hajde po e arsyetojmë diqysh. Të shuma 90 mijë euro për ndërtimin e urave mbi lumin Lepenc e neredime, këto nuk ndërtohen, ndërkaq mjetet rialokohen. Mjetet shkojnë në projektin e rregullimit të rrugëve lokale dhe rurale. Të rregullimi i rrugëve lokale dhe rurale, ju e dini se është nënshkruar kontrata, 14.06.2024, ku me i dërguar tani këto mjete, mjetet janë zotuar, ku doni me i dërguar tani që po i rialokoni, kjo është e pakuptimtë. Kur mjetet i keni të zotuar, qysh mundem me hapur procedura të prokurimit, kjo është shkelje. Me u rialokuar 425 mijë euro me një pikë të rendit të punës, duke marrë parasysh vazhdimësinë e rialokimeve për një vit, kjo i vjen se komplet mjetet po rialokohen.

**znj. Kadrije Lika-Troni:** Pyetje për drejtorin: Me herët kur debatonim për kontratën kolektive, u patët zotuar që mjetet që janë për parkingun tokësor do t'i lëmë aty, ndërsa këtu

shihet se këto mjete rialokohen për rregullimin e ngrohjes qendrore. A e keni analizuar që nëse kontrata kolektive kërkohet me u zbatuar me përmbarues, qysh keni me vepruar?

**z. Agim Çaka:** Rialokime kemi pasur edhe me herët, kemi me pasur edhe me vonë, se janë të lejuara me ligj. Sa me pak që rialokojmë mjete, punët i kemi më mirë.

**z. Bahri Selimi:** E kam potencuar edhe në KPF se çështja e rialokimeve dhe e transfereve, ju kemi lodhur me këto çështje, po bëhen në mungesë të rishikimit të rregullt të buxhetit. Shuma e mjeteve që rialokohen, e përmendi edhe Agimi, ose kanë mbetur mjetet, janë të nevojshme me u rialokuar. Ju e vëreni se nuk ka realizim të projektit. DAP është në kontakt të vazhdueshëm me MKRS, sektori i trashëgimisë kulturore, nuk ka shanse me u realizuar ky projekt. Janë afër 400 mijë euro, të cilat rialokohen. Këto mjete me mirë është me i rialokuar sesa me shkuar në suficit buxhetor. Të pyetja e Kadrijes, keni pasur të drejtë, të Kontrata kolektive, kemi thënë që nuk rrezikohen pagat, thesari ka filluar me i ekzekutuar, që mjetet të tërhiqet nga pagat, një lëndë e kemi, kemi kërkuar me u realizuar, por jo nga IK, për këtë arsye kemi filluar me i rialokuar mjetet.

**z. Agim Mani:** Shqetësimi im është, shuma 90 mijë euro për ndërtimin e urave mbi lumin lepenç, në cilin projekt shkojnë këto mjete, duke pasur parasysh nevojat për ura, në Stagovë, Biçec? Ju si ekzekutiv, nuk e merrni vullnetin me ndërtuar atë urë, por e lejoni deputetin tonë me kërkuar mjete në qeveri, ndërkaq ju i keni mjetet e nuk e rregulloni urën.

**z. Bahri Selimi:** Kontrata është arritur për rrugë lokale, por nuk d.m.th. se pas konsumimit të asaj kontrate nuk lidhet e reja. Kontrata është 2 vjeçare, që i bien se munden me u kryer edhe në vitin vijues. Mjetet të ura, shuma 90 mijë, projekti është duke u realizuar sivjet pjesërisht, ndërkaq mjetet kanë qenë të planifikuara për urën në Biçec.

**z. Qamil Stagova:** Ne i kemi paraparë në vitin 2023, 100 mijë euro për ndërtimin e urës mbi lumin lepenç. Duke pa se ajo shumë është e vogël dhe nuk mundet me u realizuar, tani për vitin 2025, i kemi paraparë 200 mijë euro për ndërtimin e urës, është paraqitur nevoja për rialokimin e mjeteve, të shumës 90 mijë euro. Është e vërtetë se u nënshkrua kontrata, por ne mundemi me realizuar me ndonjë proces tjetër.

**z. Selajdin Troni:** Po lidhem të pyetja e Agimit, me mirë me i rialokuar mjete sesa me i kthyer në suficit buxhetor. E theksove se e kemi adresuar një kërkesë deputetit për mjete në qeveri për rregullimin e urës. Deputeti e ka obligim se jemi të këtij vendi, i ka marrë votat nga ky vend, edhe pse nuk ka punuar hiq në këtë drejtim, se nuk ka sjellë ndonjë projekt për komunën tonë, projektet janë realizuar me mjete të komunës.

**z. Agim Mani:** Me intereson ana ligjore, planifikimi për rrugë rurale, me buxhet të vitit 2023, 302 mijë euro, ndërsa 276 mijë euro i ka marrë operatori ekonomik që e ka fituar tenderin, kanë ngelur edhe 30 mijë euro, tani a keni me bërë projekt të ri apo aneks projekt?

**z. Naim Beça:** Pse mjetet e nisura para 2-3 vjetëve nuk kanë përfunduar, urat është dashur me u përfunduar. Të korza a e keni pa murin, është prishur rruga të pjesa e rrugës teposhtë të "Sali Bajra", kur përfundon ai projekt? Kemi edhe shumë projekte në fshatra të cilat nuk kanë përfunduar, pse nuk i dërgoni mjetet në ato projekte?

**z. Qamil Stagova:** Është e vërtetë, është një pjesë e trotuarit, janë do shtylla, të cilat munden me u kyçur, këto punë mundemi me i kryer me projektin, Asfaltimi dhe rregullimi i rrugëve lokale e rurale.

**z. Agim Çaka:** Të diskutimi i mëhershëm, pata vërejtje të rialokimi i mjeteve të përgjithshme si fenomen-dukuri. Nëse e votoj unë tani, nuk d.m.th se jam i kënaqur, por kur të analizojmë që këto mjete duhet me shkuar dikund, atëherë të shkojnë me një vend që me të vërtetë zënë vend. Çështja është: A është si projekt i planifikuar, që mos me na dal problem që ato mjete mos mundur me u ekzekutuar, pastaj me kërkuar të rialokohen në ndonjë projekt tjetër?

**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutime të tjera nuk ka, e shtroj në votim për aprovim këtë pikë dhe e njëjta u aprovua me 16 votë Për, Kundër 6, Abstenim 3. Prezent 25. Nuk janë Florina Lika-Vishi dhe Besnik Salihu. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i komunës mori këtë:

#### VENDIM

**Për rialokimin e mjeteve sipas buxhetit te vitit 2024/ Lënda: 01Nr. 400/03-14313/24.**

5. Propozim Vendim për transferin e mjeteve sipas buxhetit te vitit 2024;

**z. Agim Mani:** E njëjtë është edhe kjo, me vet faktin që bëhet transfer i mjeteve, ekzekutivi bien ndeshë me vetveten, mjetet që transferohen të objekti i banimi social, ujësjellësi i f.. Dubravë, Kovaçec-Biçec, nuk është në rregull të shkojnë të rregullimi i rrugëve. Prej vitit 2017 janë investuar mbi 1.5 milion të banimi social, kjo është në rregull, kemi ndarë buxhet për banim social, ende nuk kemi banim social, ndërsa deri sot nuk është asnjë person i strehuar.

**znj. Arlinda Rakoci-Raka:** Shuma prej 16,000€, a rialokohet për objektin e banimit social?

**z. Selajdin Troni:** Nuk ka dështuar projekti, por është një institut që ka sjellë një vendim, është në studim të fizibilitetit. Një herë e ka sjellë një vendim, pas një ore, një vendim tjetër. Është tenderuar projekti, është fituar tenderi, janë nisur punimet, ka ardhur vendimi me i ndërprerë punimet. Ato mjete a duhet t'i lëmë ashtu, apo ti destinojmë diku tjetër.

**z. Agim Çaka:** Çështja ka të bëjë lidhur me përgjigjen që me është dhënë për objektin e banimit social. Këtu në përgjigje thuhet: Objekti i banimit social ka filluar në vitin 2017 dhe ka përfunduar në vitin 2023. Ashtu siç e tha edhe Agimi, çështja e rialokimeve dhe transfereve po bëhet në paketë, pastaj po bëhet shpërndarja e tyre, ne po i votojmë për shkak të tri të mirave, edhe një të keqe.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Çështja ka të bëjë me objektin e dytë të banimit social. Diskutime të tjera nuk ka, u shtrua në votim kjo pikë, u miratua me shumicën e votave Për, 7 votë Kundër nga LVV, Abstenuan 3 (Raif Kasa, Betim Shala, Ardita Rrahmani). Prezentë 25. Nuk janë: Florina Lika Vishi dhe Besnik Salihu. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### VENDIM

**Për transferin e mjeteve sipas buxhetit te vitit 2024/ Lënda: 01Nr. 400/03-14313/24.**

6. Propozim Vendim për Ndryshim Plotësimin e Vendimit 01 Nr. 06-350-9402/2016 të datës 30.03.2016 për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik ZK në Kaçanik të Vjetër, për ndërtimin e Impiantit, për trajtimin e ujërave të zeza;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Në vitin 2016 është marrë një vendim për lokacion për ndërtimin e impiantit për trajtimin e ujërave të zeza të Ferizaj, përfshirë edhe disa lokalitete të Kaçanikut. Impianti nuk është realizuar nga atëherë, për disa arsye që i ka pasur Ferizaj. Tani me duket se është arritur marrëveshje për ndërtimin e impiantit, parcelat janë menaxhuar pasi nuk është ndërtuar impianti, ku janë bashkuar apo ndarë parcelat. Tani është kërkuar edhe një parcelë shtesë, Parcelat tjera janë ato që kanë qenë, shpenzimet për shpronësim i bënë Ferizaj, ndërsa vendimin e merr komuna jonë, se janë në ZK të komunës tonë. Për mua është një punë e mirë,

edhe atëherë e kemi shprehur vullnetin, se po zgjidhet një problem jetik, ku përfshihen edhe një pjesë e fshatrave, si: Bajnicë, Koxhaj, Duraj, Elezaj, Gabrricë. E dhashë këtë informatë, se isha pjesë e KK edhe në vitin 2026. E hapi diskutimin:

**znj. Kadrije Lika-Troni:** duke ditur se bëhet fjalë për një projekt tejet me rëndësi për trajtimin e ujërave të zeza, se për tërë këto vite ujërat e zeza të Ferizajt kanë ardhur të ne, duke ditur se impianti po ndërtohet në ZK të komunës tonë, A ka marrë komuna jonë të gjitha informatat e duhura nga projektuesi i projektit dhe përgjegjësi i projektit në lidhje me efektet e mundshme të dëmshme mjedisore të lokacionit përreth dhe me gjerë? Pse pikërisht është zgjedhur ndërtimi i impiantit në territorin e komunës tonë, e jo në ndonjë pjesë e Ferizajt? E përmende është jetike për komunën tonë ndërtimi i impiantit. Sa % është jetike për komunën tonë e sa % është jetike për Ferizajn?

**Kryesuesi i Kuvendit:** Nga ajo që unë mendoj, se nuk jam i fushës, ujërat e zeza e kanë rrjedhjen e vet dhe nuk mundën me u trajtuar kudo. Rrjedhja ka pasur ndikim negativ në mjedis në Ferizaj, por edhe në Kaçanik. Një pjesë e madhe e fshatrave përfshihen në impiant, plus zona industriale në Doganaj. Besoj se çështja ka qenë se është menduar një pjesë e fshatrave të Ferizaj si Rakaj etj. që rrjedhja e ujit nuk ka mundur me lëvizur lartë, kjo mendoj se ka qenë arsyeja, kështu është menduar me u përfshirë kjo zonë me një pikë, besoj se ajo është studiuar dhe përcaktuar ky lokacion. Sa është jetike, sa herë ne e kemi pasur këtë problem, se ujërat e zeza kanë ardhur në territor të komunës tonë.

**znj. Kadrije Lika-Troni:** Sa % është jetike për komunën tonë e sa për Ferizajn, ndërtimi i impiantit në ZK të komunës tonë, se interesi është me i madh i Ferizajt sesa i komunës tonë?

**Kryesuesi i Kuvendit:** Me tepër erë e keqe krijohet në Ferizaj nga kanalizimet se rrjedhja e ujarëve të zeza vjen në Kaçanik, për shkak të lumenjve. Interesi i komunës tonë është se hiqen kanalizimet nga lumenjtë.

**znj. Kadrije Lika-Troni:** Të efektet e mundshme të dëmshme të mjedisit, studimi është bërë në vitin 2016. Pse me i shkaktuar komunës së Kaçanikut dëme mjedisore. A kanë dalë më i studiuar çështjet mjedisore?

**Kryesuesi i Kuvendit:** Impianti është në zonë në kufijtë Ferizaj Kaçanik, nuk besoj se ka ndikim të madh në mjedis, që lëvizë pak me poshtë e përfshihen me tepër lokalitete të komunës tonë, apo me lartë e mos me u përfshirë.

**znj. Ernesta Krasniqi:** Sa është përqindja e pjesëmarrjes së Ferizaj dhe e Kaçanikut, që po ndërtohet impianti në Kaçanik? A kemi ne pjesëmarrje me të madhe që me u ndërtuar impianti në ZK të komunës tonë?

**Kryesuesi i Kuvendit:** Për shkak të rrjedhjes se ujërave të zeza dhe pikës akumuluese, që përfshihet edhe f. Rakaj dhe fshatrat përreth, se nuk mundem me ndërtuar impiant për 4-5 fshatra.

**z. Agim Mani:** Duhet pasur parasysh, a jemi duke i bërë ne dëm Ferizajt apo Ferizaj neve? Nëse neve na bënë dem Ferizajt, ata duhet me marrë përgjegjësinë, jo ne, se e kanë obligim dhe nuk kanë të drejtë me na bërë dem. Ata duhet me gjetur pronën e vet për impiant e mos me na dëmtuar neve. Çka bëhet me fshatrat Kaçanik i Vjetër, Stagovë, Runjevë që nuk kyçen në impiant? Kjo është një e padrejtë që merren ZK në komunën e Kaçanikut, me ia zgjidhë problemet Ferizajt.

**z. Qamil Stagova:** Diku 90% nuk e di bash saktë, janë ujërat e zeza të Ferizajt, mirëpo përfitimi e kemi më të madh se komuna e Ferizajt, sepse bëhet pastrimi i lumit Neredime. Kaçaniku i Vjetër, një pjesë e Gërllicës, Stagovë, Runjevë, prapëseprapë derdhen aty, por shifra është me e vogël. Projekti i kolektorit kryesor është i paraparë nga Kaçaniku i Vjetër-Kaçanik, nuk është realizuar ende, por realizohet. Investimin e bënë komuna e bënë Banka për ndërtim dhe zhvillim, e cila me emër e ka të shënuar me ndihmën e qeverisë së Kosovës për ndërtimin e impiantit për ujërat e zeza të komunës së Ferizajt. Ne duhet shikuar në atë kuptim, se përfitimin e kemi më të madh.

**z. Rrustem Zenuni:** Ne jetojmë me një organizim juridik, ne e kemi LVL, e kemi një Asociacion të komunave, ku kanë të drejtë me bashkëpunuar për investime strategjike për zgjidhje strategjike edhe projekte të përbashkëta. Kjo nuk bënë kurrfarë dëmi, vetëm sa e zgjidhë problemin. Unë të ardhmen e shoh që komuna e Kaçanikut ka me pasur nevojë me ndërhyrë me komunën e Ferizajt, për disa fshatra të komunës tonë. Po mundohem me demonstruar se është i mundur bashkëpunimi, me u bërë zgjidhja e një problemi të një komune përmes komunës tjetër. Në të ardhmen, zgjidhja e problemit të ujërave të zeza të komunës tonë mundet me u bërë përmes lumit lepenç, në komunën e Hanit të Elezit, se ne i kemi do fshatra atje, që mundet me u bashkangjitur projekti me Hanin e Elezit për me u derdhur ujërat e zeza.

**z. Naim Beça:** Besoj se pajtoheni të gjithë, Ferizaj nuk na trajton neve njësoj. Të gjitha të mirat Ferizaj ia merr nga Kaçanikut, ndërkaq ia bien të këqijat. Na e morën ujësjellësi, çështjen e mbeturinave, ndërkaq asnjëherë nuk ka investuar në ndonjë projekt, që po thoni se komunat munden me bashkëpunuar. Asnjëherë nuk kanë bërë punë vullnetare në komunën tonë, se Ferizaj bëjnë shumë punë vullnetare. Sa herë Ferizajt vetëm sherrin ia kemi parë. Asnjëherë Ferizaj kur ka ardhur, nuk ka ardhur me trajtuar një çështje për demet që i ka bërë me fekalet në komunën tonë, që po e ndotin ambientin e 30 mijë qytetarëve të komunës tonë. Në fushatë zgjedhore secili parti ka premtuar me ndërtuar impiantin, nuk e kanë ndërtuar, po e ndërton Bashkësia evropiane. Ky impiant është tepër i vonshëm, ne i kemi fajet që nuk jemi ngritur me protestuar në forma të ndryshme demokratike. Tokat po thoni se i paguan komuna e Ferizajt, shpresoj se i paguan, shpresoj pronarët të jenë të mençur që me iu paguar mirë ato toka. Sot teknologjia ka arritur në atë nivel, që në shtetet e ndryshme të Evropës, pavarësisht lartësisë, munden me pastruar atë vend. Asnjë dëmshpërblim ne nuk e kemi marrë nga Ferizaj për demet të cilat na i ka bërë si rezultat i derdhjes se ujërave të zeza. Si rezultat i ndotjes se ambientit, sot f. Runjevë, ka shumë gjarpërinjtë të rrezikshëm se janë transformuar, ka 10- 15 gjarpërinjtë në secilin oborr të shtëpive. Komuna e Ferizajt asnjëherë nuk ka ardhur me na pyetur për demet që na i ka shkaktuar. Ne duhet me paditë në gjyq komunën e Ferizajt për demet që na i ka shkaktuar komunës tonë që sa vite. Nuk ka këtu bashkëpunim me Ferizajn.

**z. Rrustem Zenuni:** Hani i Elezit çka duhet me na bërë neve?

**z. Naim Beça:** Matjet janë bërë, i bënë shteti i Kosovës çdo 3 muaj, e kanë raportin. Oksigjeni i ujit është maksimal, mundeni me shikuar në faqen zyrtare të Institutit, ndërkaq matjet e oksigjenit në komunën tonë është me i vogël në Evropë, sidomos kur ka reshje atmosferike.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Jemi duke folur për parcelat që gjenden në Gërllicë, por që janë në ZK të Kaçanikut. Ndoshta ka edhe banorë të Ferizajt që janë pronarë të atyre parcelave, por janë në territor të Kaçanikut. Vlerësimi i ndikimit në mjedis, bëhet për faktin se Bashkimi evropian po e ndërton impiantin. Është një projekt që e kemi pritur sa kohë.

**z. Naim Beça:** Mirë që po bëhet impianti, por ne si KK as tani e as me herët nuk kemi pasur kurrfarë strategjie për demet që na janë shkaktuar nga Ferizaj.

**z. Agim Çaka:** Çështja e impiantit ka qenë sa herë një temë që e kemi diskutuar dhe na ka penguar çështja e ujërave të zeza. Kemi protestuar, dhe ai që e ka marrë me udhëheqë komunën e ka pasur në prioritet për trajtim, se kemi pasur probleme si gjatë reshjeve atmosferike, gjithashtu dhe thatësisë. Çështja që u diskutua se a ka pasur mundësi me u bërë në territor të Ferizajt, se ne si komunë kemi pak territor, megjithatë mirë që është duke u bërë. Në të ardhmen mundet me u bërë një impiant tjetër në komunën e Hanit të Elezit. Shteti i Maqedonisë mundet me na paditë për ujërat e zeza që derdhën në lum, se askush nuk ka të drejtë me i bërë dëm tjetrit. Ferizaj nuk është duke na kryer ndonjë shërbim, ndërkaq e kanë obligim me ligjet ndërkombëtare. Ne si komunë në projektet e mëdha, si autostrada që ka kaluar këtu pari, në vend se me pasur përfitime sa më të mëdha, ma tepër kemi pasur dëm, se nuk kemi pasur shumë përfitime nga ky projekt. Për këtë arsye, ne si komunë për projekte të mëdha duhet ne me qenë vigjilent, që me u bërë projekti, por me pasur komuna përfitime sa më të mëdha. Shqetësimet që paraqitën, duhet me i marrë si normale, se ata të komunës së Ferizajt dinë me u bërë të mençur që për pak nëse është në mëgje, mos me bërë impiantin në ZK të saj, por në ZK të komunës tonë.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Në vitin 2016, marrëveshja ka qenë ashtu, se ne nuk kemi pasur buxhet atëherë, dhe ka mbetur me i mbuluar shpenzimet.

**z. Agim Çaka:** Nëse vjen puna për një impiant në Han të Elezit, atëherë ne munden me na thënë Hani i Elezit që ne me i mbuluar shpenzimet.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Duhet me gjetur mënyrë me të mirë.

**z. Agim Mani:** Nuk jemi ne kundër impiantit, ne jemi kundër asaj që po i merren parcelat komunës së Kaçanikut. Problemi është Ferizaj, se ai po i bënë dëm komunës së Kaçanikut, kjo komunë duhet me dhënë diçka në kompromis. Ne duhet me insistuar si komunë me i ruajtur pronat e komunës së Kaçanikut në çdo vend.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Pronarët përfitojnë nga ato shpronësime të pronave, sikurse prej autostradës, që kanë përfituar pronarët.

**z. Selajdin Troni:** Ne nuk jemi duke i dhënë pronat, por jemi duke i shpallë me interes publik, me u hequr kundërmimi, se ju për çdo vjet keni kërkuar për çështjen e këtij projekti. Tani ka ardhur projekti, kanë me iu paguar pronat, iu lejohet ankesë deri në procedurë gjyqësore. Unë pres me u votuar impianti, që me u hequr kundërmimi në komunën e Kaçanikut.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Projekti është duke u financuar nga BE, që nuk e lënë me u bërë keq. Ka impiant që janë bërë në qytet, dëme nuk ka me bërë. Diskutime të tjera nuk ka, u shtrua në votim kjo pikë, u miratua me 15 votë Për, 5 votë kundër nga LVV, Abstenuan 2 (Naim Beça dhe Burim Shehu) Prezentë 22. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### VENDIM

**Për Ndryshim Plotësimin e Vendimit 01 Nr. 06-350-9402/2016 të datës 30.03.2016 për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik ZK në Kaçanik të Vjetër, për ndërtimin e Impiantit, për trajtimin e ujërave të zeza/ Lënda: 01Nr. 350/02-14106/24.**

Pas kësaj pike, Kuvendi bëri një pauzë 15 min. Pas pauzës u vazhdua me pikët tjera:

7. Propozim Vendim Paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite;

**Kryesuesi i Kuvendit:** E hapi diskutimin:

**z. Agim Mani:** Lista është publikuar në dhjetor 2023, pjesë e kësaj liste janë këto prona, ndryshimi nga ajo listë, është se iu ka caktuar afati kohor. Ligji thotë kështu, neni 13. Pika 2. Lista e pronave të paluajtshme për dhënien në shfrytëzim duhet të përmbajë këto të dhëna: të dhënat kadastrale të pronës: Qëllimin, destinimin, datën e publikimit të njoftimit dhe periudhën kohore për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës. Kohën e keni caktuar, qëllimin e destinimin nuk e keni caktuar. Jeni duke i dhënë 77 ha pa e ditur se për çka po i jepni. Nëse ia lëmë komisionit vlerësues, komisioni punon në bazë të kriterëve të përcaktuara me ligj. Komisioni vlerësues nuk ka të drejtë me iu dhënë destinim. Jeni duke i dhënë 85 ha pa qëllim, pa destinim, që duhet me qenë me PZHK, Plan hapësinor, që Kotlinën mos ta bëjmë vend industrial, por ta lëmë vend bujqësor.

**z. Selajdin Troni:** Destinimin ia jep komisioni në bazë të planit të biznesit dhe kriterëve. Nuk d.m.th. me ia dhënë destinimin kur t'i qesim në ankand. Ai që ka me konkurruar, konkurren me plan biznesi dhe në bazë të saj caktohet destinimi.

**z. Agim Mani:** A bazohet komisioni në PZHK apo në Plan hapësinor? Fillimisht duhet me u kryer këto procedura, pastaj me u dhënë në shfrytëzim, mos t'na ndodhë si çështja e dhënies në shfrytëzim të pronës në Kaçanik të Vjetër, për betonierkë edhe hotel në të njëjtën parcelë.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Kemi të bëjmë me Vendim paraparak me përcaktuar formën, ndërkaq ankandi i përcakton qëllimin dhe afatin kohor.

**z. Selajdin Troni:** Për Kaçanik të Vjetër, i kemi dhënë shumë herët afat, që me punuar në bazë të Planit të biznesit. Jeni ju që i keni lëshuar 3-4 mbledhje rend, duke kërkuar me ia marrë pronën me shikuar se çka po bëhet. Këta (LVV) nuk iu japin mundësi njerëzve as me punuar, por edhe kur nuk punojnë, janë kundër me ua marrë pronat, këta veç me bërë lluga.

**z. Agim Mani:** Unë i referohem ligjit, ligji thotë kështu dhe unë veproj në bazë të tij.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Ka institucione që e shqyrtojnë ligjshmërinë Agim. Diskutime të tjera nuk ka, e shtroj në votim këtë pikë, u miratua me 12 votë Për, 7 votë Kundër nga LVV, Abstenuan 3. Prezentë 22. Nuk janë prezent: Florina Lika-Vishi, Besnik Salihu, Raif Kasa, Kadri Krivenjeva, Bashkim Krasniqi. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### **VENDIM PARAPRAK**

**Për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite/  
Lënda: 01Nr. 104/02-14179/24.**

8. Propozim Vendim për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite, të pronës së paluajtshme të komunës;

**Kryesuesi i Kuvendit:** E hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë shkojmë me propozime konkrete:

**z. Qamil Stagova:** Nga Ekzekutivi, për anëtarë të komisionit: Besmir Krasniqi, Visar Mulaku, nga OJQ: Elmihane Krasniqi-Malsiu.

Nga PDK, u propozua Fatmir Bunjaku. Nga LVV u propozua Bashkim Luma.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Propozimet që dolën, i shtroj në votim për aprovim, u aprovuan me 19 votë Për, Kundër votë nuk ka, Abstenuan 3 anëtarët nga LDK( Ardita Rrahmani, Betim Shala Arlinda Rakoci-Raka). Prezentë 22. Nuk janë prezent: Kadri Krivenjeva, Bashkim Krasniqi,

Raif Kasa, Besnik Salihu, Florina Lika-Vishi. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë: Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

### VENDIM

**Për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite, të pronës së paluajtshme të komunës; ka këtë përbërje:**

- |                             |                           |
|-----------------------------|---------------------------|
| 1. Besmir Krasniqi          | anëtar (ekzekutivi)       |
| 2. Visar Mulaku             | anëtar (ekzekutivi)       |
| 3. Fatmir Bunjaku           | anëtar (PDK)              |
| 4. Bashkim Luma             | anëtar (LVV)              |
| 5. Elmihane Krasniqi-Malsiu | anëtar (Shoqëria Civile). |

9. Propozim Vendim për realizimin e një vizite zyrtare studimore e anëtarëve të Kuvendit dhe të Ekzekutivit të komunës Kaçanik, jashtë vendit - në një nga vendet e rajonit;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Vizita është parapatë edhe me planin e punës së KK, e kemi pa të arsyeshme me sjellë edhe këtu. E hapi diskutimin:

**z. Agim Mani:** Vizita zyrtare kemi pasur edhe me herët për kuvendin, tani e keni shënuar Kuvendi i Komunës dhe Ekzekutivi. Duke ditur se janë bërë vizita, por nuk keni sjellë asgjë. Është e drejtë e secilit me shkuar në vizita me sindikatë, por jo me mjetet e qytetarëve, pa e ditur se çfarë vizite është. Si komision munden me shkuar në vizita zyrtare anëtarë nga KK dhe Ekzekutivit, por jo komplet, se kjo nuk ka logjikë.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Nga praktikat e kaluara, kemi shkëmbyer përvoja me homologët tonë rreth qeverisjes lokale, mënyrën e funksionimit të qeverisjes. Ka komuna që udhëhiqen nga LVV Podujeva, Kamenica, që shkojnë në vizita zyrtare. Me ndryshe është debati kur i kemi ekzekutivin se janë të fushave të caktuara, me punë të përditshme në komunë. Ne si organ politik flasim për çështje të përgjithshme, ndërsa ekzekutivi për fusha të caktuara. Për këtë arsye e kemi përfshirë edhe ekzekutivin. Janë do çështje që na bashkojnë edhe si subjekte politike. Edhe Kuvendi i Kosovës realizon shpesh vizita me përfaqësim nga të gjitha subjektet politike.

**z. Agim Mani:** Propozoj që këtë shumë të mjeteve me ua dhënë studentëve për bursa, se studentët përfitojmë me tepër sesa ne dhe komuna përfiton kuadro nga studentët. Ekzekutivi nëse nuk është i përgatitur, pse e ka marrë detyrën.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Ne ju ftojme të gjithëve që të jeni pjesë e këtij vendimi, se janë të dobishme dhe nuk është shumë e madhe që shpenzohet, procedura shkon me prokurim.

**z. Rrustem Zenuni:** Foli për pritjet që iu kanë bërë në vizitat e realizuara në vitin e kaluar, ndërkaq i ftoj edhe subjektet tjera të jenë pjesë e këtyre vizitave. Edhe Agimin e ftoj të mos ndahet se është një ndër kontribuuesit, sot e kemi mundësinë, nesër ke dëshirë, por ndoshta nuk të krijohet mundësia, ardhja e juaj vetëm sa na plotëson.

**znj. Ardita Rrahmani:** Ne jemi komunë dhe secili duhet me na respektuar si të tillë, nuk ndihem aspak indiferente. Pajtohem me mendimin që këto mjete me mirë është me shkuar për bursa, por kur po i shoh sesi po shpenzohen mjetet në nivel qendror, atëherë nuk është shumë e madhe me realizuar një vizitë zyrtare.

**z. Agim Mani:** Bënë krahasimin me bash partiakët e juaj që jetojnë në vila. Ju jeni të kënaqur me realizuar vizita me mjete të qytetarëve. Pse nuk po realizohen vizita të vendeve tjera në vendin tonë. Mos bëjnë krahasimin e vendet tjera, se Shtimja është me përpara se komuna jonë në të gjitha aspektet.

**z. Selajdin Troni:** Realizimi i vizitave është i mirë, se përfitojmë nga to, asgjë nuk është bërë rastësisht, se çdo gjë për me arritur deri këtu, është bërë duke biseduar me miq e shoqëri, në vizita. Kur i sjell vendit të mira, mjetet nuk duhet shikuar shumë. Çka kemi përjetuar gjatë luftës dhe me gjerë, Kaçaniku ka arritur shumë, nuk është shkatërruar që 20 vjet, por është



ndërtuar, këtu vetëm regjimi i Millosheviqit ka shkatërruar, ndërkaq kushdo që ka udhëhequr ka ndërtuar, dikush me pak dikush me shumë. Ju po ndaheni gjithkund, nuk jeni në gjendje as në përvjetor me ardhur bashkë me ne.

**z. Agim Çaka:** Unë jam për, gabimi është që po lidhemi me diskutimin e individit, secili e ka mendimin e vet. Vizitat me qenë të përgatitura, me ditur kush ka me diskutuar, e jo me na u dhënë fjala pa qenë i përcaktuar. Me ditur çka ka me diskutuar, nuk d.m.th. temat me qenë të kufizuara, me i ditur specifikat e atij vendi ku shkojmë. Unë jam që KK me shkuar komplet edhe ekzekutivi, por jo jashtë tyre, se nëse dalim jashtë kësaj, atëherë del temë tjetër. Kudo që shkojmë ne, duhet me lënë përshtypje të mirë. Është e vërtetë se kemi mësuar nga vizitat e realizuara sesi funksionon KK, cilat janë vështirësitë e tyre dhe tona për funksionim të KK. Vizitat është mirë me qenë të ndërsjella, edhe ata na kanë premtuar për me ardhur të ne. Aty ku ka monumente kulturore e historike, mundet me u fokusuar DKRS.

**znj. Ardita Rrahmani:** Asnjëherë nuk kam qenë në vizita, çdo herë kam votuar Për, se është mundësi e mirë e rrjetëzimit. Ata që marrin pjesë në trajtime dhe punëtori e dinë sa e rëndësishme është lidhja e komunikimit me çdo individ tjetër që nuk është i komunës tonë, qoftë edhe në vendet Ferizaj etj. qe me ditur se Kaçaniku ka diçka që ia vlen të vizitohet. Ne mundemi me qenë kritik se asnjëherë nuk kemi pasur vizita nga vendet tjera. Ajo çka mundemi me bërë, me u ulur me bërë një program, çka mundemi ne me iu paraqitur atyre që me ardhur ata me na vizituar neve, e drejtë e secilit është me pasur mendimin ndryshe. Ata që kanë marrë pjesë në trajnime e punëtori jashtë Kaçanikut, duhet ditur rëndësinë e komunikimit me vendet tjera. Unë mundohem me paraqitur komunën e Kaçanikut kudo që shkoj në formën me të mirë të mundshme, pavarësisht se kush është kryetar. Si grup i LDK jemi për, dhe jam që kudo që shkojmë me i bindë Ferizajn, Shtimen, me bërë një vizitë në Kaçanik, se kush vjen në Kaçanik njëherë vjen edhe herën e dytë se jemi më mikpritësit në Kosovë.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutime të tjera nuk ka, u shtrua në votim kjo pikë, u miratua me 16 votë Për, 7 votë kundër nga LVV, Abstenim nuk ka. Prezentë 23. Nuk janë prezent: Florina Lika-Vishi, Besnik Salihu, Raif Kasa, Kadri Krivenjeva. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### VENDIM

**Për realizimin e një vizite zyrtare studimore e anëtarëve të Kuvendit dhe të Ekzekutivit të komunës Kaçanik, jashtë vendit - në një nga vendet e rajonit/ Lënda: 01Nr. 60/01-14105/24.**

10. Propozim Vendim për Ndryshim Plotësimin e Vendimit 01 Nr. 60/01-38152/21 të datës 29.12.2021 për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Meqë anëtarja e KK nga PDK- Fitore Vishi ka dhënë dorëheqje, atëherë duhet të plotësohet KPF me një anëtar nga ky subjekt politik. Kërkoj nga PDK të jap një propozim konkret.

**z. Fatmir Bunjaku:** Subjekti politik i PDK e propozon për anëtar të KPF të emërohet: Rrustem Zenuni.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Ndonjë propozim tjetër nuk ka, atëherë propozimin që në vend të Fitore Vishi e cila ka ofruar dorëheqje nga KK për shkak të punësimit në Shërbimin Civil, me çka me automatizëm i kanë pushuar edhe pozitat e ndërlidhura me KK, në KPF për anëtar emërohet Rrustem Zenuni, e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Prezentë 23. Nuk janë prezent: Florina Lika-Vishi, Besnik Salihu, Raif Kasa, Kadri Krivenjeva. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### VENDIM

**Për Ndryshim Plotësimin e Vendimit 01 Nr. 60/01-38152/21 të datës 29.12.2021 për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.**

Me ndryshim plotësimet që bëhen, Komiteti për Politikë dhe Financa, ka këtë përbërje:

2.1 Kemal Murseli	PDK	Kryesues sipas funksionit
2.2 Kadri Krivenjeva	PDK	anëtar
<b>2.3 Rrustem Zenuni</b>	<b>PDK</b>	<b>anëtar</b>
2.4 Agim Mani	LVV	anëtar
2.5 Kadrije Lika-Troni	LVV	anëtar
2.6 Ardita Rrahmani	LDK	anëtar
2.7 Rabije Sallahi	AAK	anëtar/ Lënda: 01Nr. 60/01-14084/24.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Theksoj se z. Rrustem Zenuni është i obliguar të jap dorëheqje në pozitat tjera të emëruara nga KK.

11. Propozim Vendim për miratimin e Raportit përfundimtar Nr. 08-320/01-11894/24 të komisionit komunal për vlerësimin e dëmeve nga reshjet e breshërit në territorin e komunës së Kaçanikut, në Llanishtë dhe Kotlinë;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Drejtori është këtu, raportin e keni marrë, nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin:

**z. Rrustem Zenuni:** Kërkoj nga komisioni që të dal në vendngjarje edhe në vendet tjera për dëmet e shkaktuara nga reshjet breshëri.

**z. Suhad Dullovi:** Në mbledhjen e KPF u diskutuar raporti i cili iu ka ardhur edhe në KK. Raporti është i bazuar edhe në Ligjin 04/L-27. Baza ligjore është në vendim, është prej ministrisë se duhet me u miratuar në KK. E dyta, sa i përket Bujqësisë që u diskutuar, unë jam shumë i kënaqur se kemi dhënë kontribut nga dita kur jam drejtor, iu kemi dhënë mbështetje fermerëve. Në vitin 2022-2024 janë mbështetur gjithsej 860 fermerë.

**z. Agim Mani:** Në mbledhjen e KPF e kemi diskutuar se nuk e dinim se a ka bazë ligjore apo jo, për faktin se komisioni është i formuar nga ekzekutivi, qysh me ardhur në KK kur nuk kemi asnjë anëtar nga KK në këtë komision. Mirë jeni bazuar në ligj, Ligji thotë: komisioni të formohet në bazë të profesioneve të ndryshme. E keni formuar vetëm një komision, shpresoj të jenë përfshirë të gjithë dëmtuesit në komunën që ata të gëzojnë të drejtën e kompensimit të dëmeve nga të reshurat.

**z. Suhad Dullovi:** Rregullorja neni 12. Pika 1 paragrafi 6, thotë se formohet komisioni komunal, nga Kryetari i komunës, vendimin e merr KK. Presin nga ministria që t'iu kompensohet dëmi fermerëve të dëmtuar nga breshëri.

**z. Agim Mani:** Një vendim i tillë është marrë edhe në vitin e kaluar, nuk e di a ua kanë mbuluar dëmet e shkaktuara nga breshëri.

**z. Suhad Dullovi:** Unë kam pasur dy takime me Agjencinë, tani ajo procedurë nga agjencinë është në Zyrën e Kryeministrit.

**z. Agim Çaka:** Besoj se komisioni ka qenë real në vlerësimin e dëmeve, e ka përfshirë të gjithë sipërfaqen e dëmeve nga reshjet e breshëri, që mos të ketë ankesa se nuk është përfshirë ndonjë dëmtues.

**z. Naim Beça:** Në mbledhjen e kaluar e kam ngritur problemin e dëmeve të shkaktuara nga reshjet dhe fatkeqësitë e krijuara nga reshjet. Përgjigjen e kam marrë se, do të kujdesëm për parandalimin e tyre. Me mirë kishte me qenë ky komision me u marrë për parandalimin e fatkeqësive natyrore, e jo pasi të ndodhë fatkeqësia. Në muajin e kaluar e kam potencuar të përroi i Rakocit me intervenuar. Përgjigja ka ardhur, se kemi me intervenuar. Ta shohim sesa do të mbani këtë premtim rreth sigurisë së qytetarëve atje.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutime të tjera nuk ka, u shtrua në votim kjo pikë, u miratua njëzëri. Prezentë 22. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### VENDIM

**Për miratimin e Raportit përfundimtar Nr. 08-320/01-11894/24 të komisionit komunal për vlerësimin e dëmeve nga reshjet e breshërit në territorin e komunës së Kaçanikut, në Llanishtë dhe Kotlinë/ Lënda: 01Nr. 370/01-14270/24.**

12.Rekomandimi i komisionit vlerësues 01Nr. 104/02-11398/24 -për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës për 99 vite, në Zonën Kadastrale Doganaj, ofertuesit ROYAL BENVERAGE LL.C;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Rekomandimin e komisionit vlerësues e keni marrë, e hapi diskutimin:

**znj. Ernesta Krasniqi:** Shprehi shqetësimin tim për këtë komision vlerësues, për faktin se në komision është edhe Adnan Reka, i cili ka dhënë dorëheqje nga KK, si rrjedhojë e kësaj ai nuk është pjesë e asnjë komisioni. Komisioni vlerësues i ka bërë ftesë për mbledhje ish anëtarit të KK Adnan Reka i cili ka ofruar dorëheqje me 04.04.2024. Përkundër faktit se ka ofruar dorëheqje, një ftesë ia kanë bërë në muajin prill dhe një në muajin maj. Në muajin maj është deklaruar edhe vet ish anëtari i KK Adnan Reka se nuk është më pjesë e KK. Shqetësimi im është: Pse nuk është bërë ndryshim plotësimi i komisionit vlerësues, dhe pse është keqpërdorë emri i tij, duke e shënuar si mospjesëmarrës.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Në momentin që është miratuar nga KQZ dorëheqja e tij dhe është zëvendësuar nga KK, me nuk është pjesë e KK. Komisioni vlerësues i ka pasur lëndët në procedurë, kuorum ka pasur dhe ka vazhduar me punën edhe në mungesë të një anëtar. Secili komision ka funksion nëse një anëtar jep dorëheqje dhe që ka kuorum për me vazhduar me procedurë.

**znj. Ernesta Krasniqi:** Edhe KPF ka kuorum, por sot u bë zëvendësimi. Është dashur me u bërë ndryshim plotësimi i komisionit vlerësues, se me 04.04. 2024 ka ofruar dorëheqje, me 24.04.2024, i është bërë ftesa për mbledhje të komisionit.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Mbledhja e KPF ka vazhduar edhe pa një anëtar. Dorëheqjen është një organ tjetër që i aprovon, nuk jam unë, është KQZ. Komisioni ka qenë në përfundim të procesit. Në momentin që e kemi marrë nga KQZ miratimin e dorëheqjes se Adnanit, kemi marrë veprime për zëvendësimin e tij.

**znj. Ernesta Krasniqi:** Pse ka vazhduar me mbetur emri i tij në komision?

**Kryesuesi i Kuvendit:** Ka vazhduar me mbetur deri me konfirmimin e aktit të dorëheqjes nga KQZ. Askush nuk e kemi atë përgjegjësi me ia hequr emrin Adnanit nga KK, përpos KQZ.

**znj. Ernesta Krasniqi:** Me çfarë datë është aprovuar nga KQZ, dorëheqja e Adnanit?

**Kryesuesi i Kuvendit:** Vendimi është i publikuar në faqen zyrtare.

**z. Agim Mani:** Komisioni vlerësues mendoj se ka rëndësi të madhe për dhënien në shfrytëzim të pronave komunale, për atë duhet me qenë i kompletuar ashtu siç e përcakton ligji, Komisioni i ka 5 anëtarë, jo 4. Adnani ka dhënë dorëheqje me 04.04.2024 nga KK dhe nga komisionet, ndërkaq me 05.04.2024 është shpallë Ankandi publik. Ju si kryesues është dashur me shtyrë publikimin e ankandit.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Asnjë kompetencë nuk e kam unë me u marrë me ankande, ankandi ka rregulla dhe procedura, janë rregullat e veçanta. Dorëheqjen e Adnanit unë e marrë zyrtarisht nga KKZ. Për mua është dorëhequr një anëtar kur të marrë konfirmimin nga KQZ se është aprovuar dorëheqja. Unë i respektoj rregullat ligjore.

**z. Agim Mani:** Emaili i dorëheqjes ju ka ardhur juve.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Anëtari që jep dorëheqje e ka obligim me njoftuar KKZ, jo mua. Është institucioni se kujt duhet me iu adresuar dorëheqja, KKZ me ka njoftuar, faleminderit që me ka njoftuar, por nuk jam organ që e largoj nga komisioni, kur zyrtarisht ai është ende anëtar. Në momentin që KQZ e aprovon dorëheqjen e tij, ajo është zyrtare. Zyrtarisht dorëheqja aprovohet nga KQZ, KKZ zyrtarisht na njofton me vendimin e KQZ për zëvendësimin e anëtarit në fjalë, se ne nuk bëjmë zëvendësimin e anëtarëve të KK. Zëvendësimi i Adnanit është bërë me anëtarin Burim Shehu.

**z. Agim Mani:** Mbledhja e KK është mbajtur në muajin maj dhe nuk e keni zëvendësuar.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Lënda ka qenë në proces.

**z. Selajdin Troni:** Edhe pas ftesës së dytë që iu ka bërë Adnanit, nuk ka njoftuar se ka ofruar dorëheqje. Ai na ka thënë se nuk mundem me qenë pjesë e komisionit, e nuk ka njoftuar se ka ofruar dorëheqje. Komisioni nuk mundet me mbetur peng i një anëtar, se mundet zëvendësimi mos me u bërë një kohë.

**znj. Ardita Rrahmani:** Krejt këtij diskutimi i duhet një përgjigje. A është komisioni legjitim në mungesë të një anëtar?

**Kryesuesi i Kuvendit:** Sipas neve, po.

**znj. Ardita Rrahmani:** Atëherë u shterë debati për këtë çështje. Edhe në KPF është ngritur kjo çështje dhe unë kam qenë ajo që kam reaguar. Unë punoj me ligjin dhe e njoh ligjin. Në rast se ligji thotë se komisioni është legjitim pa një anëtarë, në rregull jemi, vazhdojmë.

**znj. Ernesta Krasniqi:** Adnani iu ka dërguar email, me ka bërë forvard edhe mua, ku shkruan që nga 04.04.2024 nuk jam më anëtar i KK. I ka shkruar kryetares së komisionit vlerësues Gentiana Kastratit-Sallahu, se nuk jam pjesë e KK dhe si rrjedhojë nuk marrë pjesë as në komision, ndërkaq në komision është shënuar emri i Adnanit. Pse nuk është zëvendësuar Adnani?

**Kryesuesi i Kuvendit:** A e kupton Ernesta se kjo nuk mjafton, pa u aprovuar zyrtarisht dorëheqja nga KQZ. Procesi kur e ka dhënë betimin Burimi ka qenë në fund, me 29.04.2024. Nëse Adnani e ka ditur që nuk ka me qenë pjesë e komisionit, pse ka hyrë në komision?

**z. Qamil Stagova:** Adnani me ka dërguar një mesazh, me ka thënë se tentova me ardhur, por nuk munda. Besoj se nuk mundem me ardhur, besoj se duhet të zëvendësohem.

**znj. Ernesta Krasniqi:** Drejtor a e ke lexuar emailin që ia ka dërguar Adnani kryetares së komisionit?

**z. Selajdin Troni:** Adnani pas ftesës së parë që iu ka bërë, ka pohuar se nuk mundet të jetë pjesë e komisionit, ndërkaq nuk ka ofruar diçka me shkrim se ka ofruar dorëheqje. Zëvendësimi i Adnanit në KK është bërë në fund të muajit prill.

**znj. Ernesta Krasniqi:** Në muajin maj Adnani nuk ka qenë anëtar i KK, zëvendësimi është bërë në fund të muajit prill. Qysh mundet me qenë Adnani pjesë e komisionit, pa qenë pjesë e KK?

**Kryesuesi i Kuvendit:** Adnani e ka dhënë dorëheqjen me 04.04.2024, ku është zëvendësuar me Burim Shehu. Mbledhja e radhës ka qenë me 31 maj. Ne zëvendësimet i bëjmë në mbledhje të KK. Cila ka qenë arsyeja me zëvendësuar në komision vlerësues në muajin maj Adnanin?

**znj. Ernesta Krasniqi:** Pse me ia shënuar emrin Adnanit në muajin maj në komision, kur është e njoftuar kryesuesja e komisionit?

**Kryesuesi i Kuvendit:** Ja ka shënuar se ka qenë pjesë e komisionit?

**z. Agim Çaka:** Çështja e dhënies në shfrytëzim të pronës komunale, po kemi probleme se nuk e kemi PZHK dhe Hartat Zonale. Hartat zonale kryejnë shumë punë, përfshijë zonat bujqësore, zonat urbane, zonat turistike. Nuk ka mundësi që dikush që ka një restorant aty, me hapur një biznes krejt tjetër, si gurthyes apo betonierkë. Duhet me pasur kujdes në këtë renditje, që veprimtaritë mos të pengojnë njëra tjetrën.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Rekomandimet e komisionit shqyrtohen veç e veç, këtu kemi të bëjmë me një ofertë e Arsi Cola që ka shpreh interesimin me ndërtuar një fabrikë të ujit dhe lëngjeve, të fusha e Mulës në Doganaj. Kjo kompani zotohet për një investim shumë të madh, besoj se nuk ka pasur deri me tani në komunën e Kaçanikut. Nga fabrikat që i kanë në Gjilan, besoj secila komunë i kishte ofruar partneritet, meqë ka siguruar disa burime të ujit në Firajë. Sipas performancës në Gjilan, mendohet për një kompani serioze.

Sa e mora një konfirmim këtu se Adnani nga pozita e mësimdhënësit ka ofruar dorëheqje me 1 mars, ndërsa komisioni vlerësues është formuar në mbledhjen e KK në fund të marsit, 29.03.2024.

**znj. Ernesta Krasniqi:** Ai ka menduar se ka të drejtë me i mbajtur dy pozitat. Puna e juaj ka qenë me zëvendësuar, e jo cilën pozitë do të mbajë.

**Kryesuesi i Kuvendit:** E kuptoj, ndoshta ka menduar se ka të drejtë me qenë në dy pozitat. Si do që të jetë, po të kishit lexuar ligjin me mirë atëherë sikurse tani, e kishit kuptuar se nuk ka pasur të drejtë me i mbajte dy pozitat. Paraprakisht e keni ditur se Adnani ka me kaluar në ministri, por keni menduar se ka të drejtë me i mbajtur dy pozitat.

**z. Agim Mani:** Po jepen në shfrytëzim 3 ha, për një biznes me vlerë të investimit 5 milion euro. A e keni parasysh sa janë 3 ha? Në atë sipërfaqe ka mundësi me u zhvilluar shumë biznese. Të çështja e Adnanit, po të kishte qenë pjesëmarrës Adnani, pas dorëheqjes, a do të ishte ai komision legjitim? Jo, se ka dhënë dorëheqje. Ligji e thotë qartë që komisioni duhet të jetë prej 5 anëtarëve. Komisioni nuk i ka pasur 5 anëtarë, i ka pasur 4 anëtarë. A është e drejtë apo jo, e vlerësoni ju? Ju i keni numrat, mundeni me i kaluar gjithçka, por jo me neve. Edhe pikat tjera janë të natyrës së njëjtë, kështu që ne nuk do të qëndrojmë në mbledhje, për shkak se komisioni vlerësues nuk ka qenë legjitim. Kështu që ne LVV do të lëshojmë mbledhjen.

Me këtë rast, 7 anëtarë të LVV e lëshuan mbledhjen.

**Kryesuesi i Kuvendit:** A është vendimi i ligjshëm apo jo e vlerëson tjetërkush.

Në sallën mbetën 16 anëtarë (10 PDK, 3 LDK, 2 AAK 1 NISMA), ndërkaq 4 anëtarë kanë dalë me herët (Florina Lika-Vishi, Besnik Salihu, Raif Kasa, Kadri Krivenjeva).

**z. Agim Çaka;** Për sqarim, unë thashë se si komunë është mirë me pasur zona industriale. Kur kemi kërkesa për minifabrika etj. të ndërtohen në zona industriale, e mos të ndërtohen afër vendbanimit, se aty ka kritere, çështja e kanalizimeve, ndotja e ambientit etj.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Është zonë ekonomike ajo pjesë. Vendbanim nuk ka, mbi 500 metra larg shtëpitë, ajo pjesë është zonë ekonomike. Shihet se është një investitor serioz, i ka siguruar burimet e ujit, donë me investuar, i ka dëshmuar investimet e tija edhe në komunat tjera. Ne

mundemi mos me u pajtuar me rekomandimin e komisionit, por një investim 5 milion euro, në 50 ari tokë, nuk vjen një biznes me investuar. Në aspektin ekologjik, nuk ka me të arsyeshëm se destilimi i ujit dhe nuk është ndotës. Ne mund të votojmë për apo kundër, besoj secila komunë kishte pas dëshirë me pasur në komunën e vet një investitor të tillë.

**z. Selajdin Troni:** Kompania është serioze, kërkoj që komisioni të jetë i rregullt në përcjelljen e punimeve të kompanive, a ia ka filluar punët, deri ku arrijnë punimet e kështu me radhë, e mos të vjen puna me i tërhequr për shkak të mos mbikëqyrjes. Kompania është serioze dhe unë jam për me ia dhënë në shfrytëzim pronën, vetëm mbikëqyrja e komisionit mos të mungoj.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutime të tjera nuk ka, u shtrua në votim kjo pikë, u miratua njëzëri. Prezentë 16. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### VENDIM

**Për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për nëntëdhjetenëntë (99) vjet pronën e paluajtshme të komunës së Kaçanikut në Zonën Kadastrale Doganaj të Kaçanikut, përmes shprehjes së interesit, kompanisë ROYAL BENVERAGE LL.C nga f.Velekincë, Gjilan, me përfaqësues Fejzulla Mustafa/ Lënda: 01Nr. 104/02-11398/24.**

13.Rekomandimi i komisionit vlerësues 01Nr. 104/02-11401/24 -për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës për 99 vite, në Zonën Kadastrale Koxhaj, ofertuesit X Pro Inovation LLC;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Rekomandimin e komisionit e keni marrë, nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin:

**z. Betim Shala:** Meqë bëhet fjalë për investim i cili se pari i ka kaluar të gjitha filtrat në komunë, kemi një fabrikë e cila do të prodhon blloka ekologjik, 100% riciklues dhe term izolues, e para në Ballkan. Sa i përket çështjeve mjedisore, këto rregullohen me leje mjedisore, LDK e përkrahim këtë rekomandim.

**z. Agim Çaka:** Mos të ketë probleme për vendbanim, mos të ketë telashe për banorë, mos të ketë interes individual grupor, për mos me pasur pastaj ankesë prej banorëve, mos të ketë ndotje të ambientit, mos të ketë zhurmë, pse ka prodhim, punësim, na jemi për atë punë. Duhet me shikuar veprimtaritë që zhvillohen, se mundet me pasur edhe turizëm, ne duhet me shikuar se a shkojnë aty dy veprimtari bashkë.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Aty është krijuar një mini zonë industriale. Zona është industriale, diskutime të tjera nuk ka, e shtroj në votim rekomandimin e komisionit. Për ish-in 6 anëtarë, kundër votuan 9 anëtarë. Prezentë 15. Nuk është Bashkim Krasniqi. Në saje të rezultatit të votimit, konstatohet se Kuvendi i Komunës mori këtë

#### VENDIM

**NUK MIRATOHET Rekomandimi i komisionit vlerësues 01Nr. 104/02-11401/24 -për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës për 99 vite, në Zonën Kadastrale Koxhaj, ofertuesit X Pro Inovation LLC/ Lënda/01Nr. 104/02-11401/24.**

14. Rekomandimi i komisionit vlerësues 01Nr. 104/02-11400/24 -për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës për 99 vite, në Zonën Kadastrale Koxhaj, ofertuesit Suad Koxha;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Rekomandimin e komisionit e keni marrë, është fjala për një biznes për prodhime të qumështit. Vlera e investimit është e vogël, por unë e kam pa të arsyeshme të

mbështeti se është vendas aty. Nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë e shtroj në votim për aprovim këtë pikë. Rezultati i votimit ishte; 6 votuan Për, Kundër 9. Prezent 15. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### VENDIM

**NUK MIRATOHET Rekomandimi i komisionit vlerësues 01Nr. 104/02-11400/24 -për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës për 99 vite, në Zonën Kadastrale Koxhaj, ofertuesit Suad Koxha/ Lënda: 01Nr.104/02-11400/24.**

**z. Agim Çaka:** A ka mundësi pas votimit me u diskutuar. Komisioni vlerësues po i rekomandon, nuk është mirë me luajtur kështu.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Unë isha Për, unë nuk jam kundër të asnjë investimi. Në këtë rast përkundër atij që është vendas aty, ne kemi dërguar edhe njerëz tjerë aty. Është mendimi i secilit, unë nuk mundem të ia imponoj mendimin askujt.

**znj. Ardita Rahmani:** Kur komisioni i jep këto rekomandime, e nuk kalojnë, me intereson të dijë komisioni vlerësues a e ka kryer punën si duhet? Çka ndodhë me atë komision? A ka kredibilitet me qenë përsëri ai komision? Ai komision duhet me u shkarkua.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Komisioni e ka kryer punën e vet.

**z. Agim Çaka:** A ka mundësi me shtruar edhe një herë në votim se ndoshta nuk janë të njoftuar sa duhet me çështjen, ose anëtari i Komisioni t'na e shpjegon.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Unë e diskutova edhe me herët, që realisht nuk jam kundër asnjë investimi, në këtë rast përkundër ai që është vendas, ne kemi dërguar edhe njerëz tjerë aty, është mendimi i secilit me votuar për apo kundër.

**z. Selajdin Troni;** Ne si komision e kemi shqyrtuar lëndën, për investimin që ka me realizuar, ne e kemi vlerësuar se është në rregull. Në pjesën e objektit ka me investuar 50 mijë euro, objekti është i gatshëm, vetëm renovimi, ndërtimi i rrethojave nga druri 13 mijë euro, i stallave 24 mijë, ndërtimi i dyqanit për shitje të produkteve, 10 mijë, rrugë parkingje, 8 mijë, sera 5 mijë, mjete bujqësore 10. Shuma e përgjithshme, 120 mijë euro.

**z. Agim Çaka:** Kryesues, a po e shtron edhe njëherë në votim (fjala është për pikën 14).

**Kryesuesi i Kuvendit:** Po Agim, po e shtojmë edhe njëherë në votim pikën 14. Atëherë kush është për ? Për votuan 8 anëtarë, Kundër 7 anëtarë. Prezentë 15. Nuk është Bashkim Krasniqi. Në saje të kësaj del konstatimi se pika e 14 KALOJ. Vendimi i parë është valid, por me kërkesën e juaj e shtrova në rivotim.

**znj. Arlinda Rakoci:** Kërkoj me u rikthyer në rivotim edhe pika e 13, pasi u kthye pika e 14.

**z. Agim Çaka:** Kryesues ne kërkuam sqarim, se nganjëherë po përzihen pikat. Anëtari i komisionit e dha sqarimin. Unë kam të drejtë me votuar ndryshe.

**z. Rustem Zenuni:** Rikthimi në votim i pikës, është shkelje e rregullores.

**z. Agim Çaka:** Nuk është shkelje e rregullores. Anëtari i komisionit e dha një sqarim dhe unë kam të drejtë me votuar ndryshe.

**znj. Ardita Rrahmani:** Është tjetërkush që e vlerëson a është shkelur rregullorja.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Është e qartë që pasi të mbyllet votimi, më nuk kthehet në atë pikë, pasi ka reagime, nuk mundemi ta konstatojmë si të rregullt atë çështje. Meqë ka reagime, atëherë mbetet votimi i parë.

**z. Agim Çaka:** Vetëm një reagim ishte kryesues.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Ose i kthejmë të dyja në rivotim ose asnjërën. A jeni që t'i kthejmë në rivotim serish të dy pikat 13 dhe 14. Për me i kthyer dy pikat në rivotim, pikët 13 dhe 14 votuan 9 anëtarë. Kundër 6. Abstenim nuk pati. Prezentë 15. Nuk ishte Bashkim Krasniqi.

**z. Rrustem Zenuni:** Kjo është tallje kryesues.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Votimi vlen për dy pikët: 13 dhe 14. Për shkak të kërkesës me i kthyer në rivotim pikat kthehen në rivotim, pikat 13 dhe 14, atëherë vazhdojmë me pikën 13.

13.Rekomandimi i komisionit vlerësues 01Nr. 104/02-11401/24 -për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës për 99 vite, në Zonën Kadastrale Koxhaj, ofertuesit X Pro Inovation LLC;

Prezentë në sallë janë 9 anëtarë, (3 PDK, 3 LDK, 2 AAK, 1 NISMA).

Në vazhdim Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Murseli, konstatoj se nuk mundemi me vazhduar me mbledhjen në mungesë të kuorumit, atëherë shkojmë në pauzë 10 min.

Pas 10 minutave pauzë, Kryesuesi i Kuvendit konstatoj kuorumin me vazhduar mbledhjen, por në mungesë të kuorumit, theksoj se nuk mundemi me vazhduar tutje. Në sallë janë 9 anëtarë. Mbetet të caktojmë vazhdimin e seancës për pikët 13-15, për një ditë tjetër.

Vazhdimi i Mbledhjes 6 i datës 28.06.2024, u caktuar me u mbajtur me 03 korrik 2024 e mërkurë në ora 11:00. Nga administrata kërkoj që të njoftohen anëtarët tjerë të cilët nuk janë këtu, për datën e vazhdimit të mbledhjes.

Mbledhja i ndërpreu punimet në ora 15:37, në mungesë të kuorumit. Në sallë janë 9 anëtarë (3 PDK, 3 LDK, 2 AAK, 1 NISMA). Gjatë mbledhjes kanë dalë me herët: Florina Lika-Vishi, Besnik Salihu, Raif Kasa, Kadri Krivenjeva. Pas pikës 11 e lëshuan mbledhjen 7 anëtarë të LVV. Nga pika 13 nuk ishte Bashkim Krasniqi. Pas pauzës, nuk u kthyen 6 anëtarë tjerë të PDK.

Procesmbajtës  
Makfire Malsiu  
*Makfire Malsiu*

Kryesues i Kuvendit  
Kemal Murseli  
*Kemal Murseli*





**REGJISTËRI I ANTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS**  
**(të zgjedhur në votimet e datës 17 Tetorit 2021);**

**Nga Mbledhja e VI (gjashtë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës për vitin 2024, mbajtur me 28.06.2024**

1. Kemal Murseli .....
2. Brahim Imishti.....
3. Hamide Luma .....
4. Kadri Krivenjeva .....
5. Lirije Dema.....
6. Rrustem Zenuni.....
7. Edon Baftiu .....
8. Selajdin Troni .....
9. Fatmir Bunjaku .....
10. Bashkim Krasniqi .....
11. Florina Lika-Vishi .....
12. Lejla Muhaxheri-Çaka.....
13. Agim Mani .....
14. Kadrije Lika-Troni .....
15. Burim Shehu .....
16. Naim Beça .....
17. Raif Kasa .....
18. Ernesta Krasniqi.....
19. Bashkim Luma .....
20. Arta Avdiu .....
21. Ardita Rrahmani .....
22. Besnik Salihu .....
23. Betim Shala,.....
24. Arlinda Rakoci-Raka.....
25. Rabije Sallahi.....
26. Ekrem Livoreka.....
27. Agim Çaka.....



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kaçanik  
Municipal of Kaçanik

01Nr. 60/03-14299/24  
Kaçanik, 03.07.2024

## PROCESVERBAL

**Nga Vazhdimi i mbledhjes së VI (gjashtë)** të rregullt të Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2024 (Legjislatura e shtatë) të datës 28.06.2024. Mbledhja i vazhdoj punimet me datën 03.07.2024 në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës prej 27 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje ishin 18 anëtarë. Munguan: 9 anëtarë (8 anëtarët nga LVV dhe Besnik Salihu-LDK).

Nga Ekzekutiviti i Komunës ishin prezentë: Nënkryetari i Komunës-Sabedin Vishi, Drejtorët e drejtorive: Qamil Stagova- DUKMM, Suhad Dullovi- DBPZHR, Pranvera Loku-Zharku-DZHET, Dardana Tafili-Dauti-DAP, ndërkaq nga zyrtarët: Bejtulla Dalloshi, Makfire Malsiu, Mavije Murseli.

Nga strukturat vendore mbledhja monitorohet përmes Teleprezencës nga Vjosa Ahmetaj- zyrtare në MAPL. Vazhdimi i mbledhjes ka transmetim të drejtpërdrejtë.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Murseli- Kryesues i Kuvendit  
Procesmbajtës, Makfire Malsiu - Zyrtare e lartë për punë të KK.

**Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Murseli:** Të nderuar pjesëmarrës, së pari iu përshëndes të gjithëve, iu dëshiroj mirëseardhje, konstatoj kuorumin, kushte pune ka, vazhdojmë me punimet e mbledhjes së VI (gjashtë) të rregullt të Kuvendit të Komunës të datës 28.06.2024, e cila mbledhje u ndërpre në mungesë të kuoromit. Vazhdimi i mbledhjes u bë me 03.07.2024, me pikat e rendit të punës si vijon:

13. Rekomandimi i komisionit vlerësues 01Nr. 104/02-11401/24 -për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës për 99 vite, në Zonën Kadastrale Koxhaj, ofertuesit X Pro Inovation LLC;
14. Rekomandimi i komisionit vlerësues 01Nr. 104/02-11400/24 -për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës për 99 vite, në Zonën Kadastrale Koxhaj, ofertuesit Suad Koxha;
14. Rekomandimi i komisionit vlerësues 01Nr. 104/02-11403/24 -për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës për 99 vite, në Zonën Kadastrale Kotlinë, ofertuesit ECO-EXCLUSIV Sh.P.K.

Në vazhdim Kryesuesi i Kuvendit –Kemal Murseli, e njoftoj KK se kam kërkuar interpretim ligjor nga MAPL, për çështjen e kthimit në rivotim të pikave 13 dhe 14, nuk kemi marrë ende ndonjë konfirmim nga MAPL. Unë kam kërkuar të me japim një konfirmim zyrtar sot para mbledhjes, por nuk kemi deri me tani konfirmim. Në ligj dhe rregullore nuk e kam pa se është në kundërshtim rivotimi.

Vazhdojmë me pikën 13

13. Rekomandimi i komisionit vlerësues 01Nr. 104/02-11401/24 -për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës për 99 vite, në Zonën Kadastrale Koxhaj, ofertuesit X Pro Inovation LLC;

E hapi diskutimin:

**z. Rrustem Zenuni:** Ne si grup i PDK kemi vendosur mos të marrim pjesë në vazhdimin e seancës, deri sa të kthehet një përgjigje nga MAPL.

**Kryesuesi i Kuvendit:** A jenë duke folur në emër të grupit të PDK, se unë jam pjesë e grupit, por kam me qëndruar në sallë.

**z. Rrustem Zenuni:** Jam duke folur si grupit i KK.

Me këtë rast, 10 anëtarë të KK e lëshuan mbledhjen, 8 (tetë) anëtarë të PDK (Rrustem Zenuni, Fatmir Bunjaku, Florina Lika-Vishi, Lejla Muhaxheri Çaka, Hamide Luma, Lirije Dema, Brahim Imishti, Edon Baftiu), 2 (dy) anëtarë të AAK (Ekrem Livoreka, Rabije Sallahu).

Në sallë mbetën: 8 anëtarë: 4 –PDK, 3 -LDK, 1- NISMA.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Atëherë, pasi jeni për me pritur konfirmimin ligjor, kuorum nuk ka me vazhduar mbledhja, besoj se MAPL na e jep një konfirmim ligjor. Nëse ata konstatojmë se nuk kemi pasur të drejtë me i kthyer në rivotim pikët 13 dhe 14, atëherë e trajtojmë vetëm pikën 15.

**Data e vazhimit të mbledhjes së 6 të rregullt të KK të datës 28.06.2024, mbeti të caktohet pasi të marrim konfirmimin e ligjshmërisë nga MAPL.**

Mbledhja u ndërpre në mungesë të kuorumit në ora 11:15.

Procesmbajtës  
Makfite Malsiu



**REGJISTËR I ANTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS**  
**(të zgjedhur në votimet e datës 17 Tetorit 2021);**

**Nga Mbledhja e VI (gjashtë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës për vitin 2024 e datës 28.06.2024 -Vazhdimi i mbledhjes, 03.07.2024**

1. Kemal Murseli .....,
2. Brahim Imishti.....,
3. Hamide Luma .....,
4. Kadri Krivenjeva .....,
5. Lirije Dema.....,
6. Rrustem Zenuni.....,
7. Edon Baftiu .....,
8. Selajdin Troni .....,
9. Fatmir Bunjaku .....,
10. Bashkim Krasniqi .....,
11. Florina Lika-Vishi .....,
12. Lejla Muhaxheri-Çaka.....,
13. Agim Mani .....,
14. Kadrije Lika-Troni .....,
15. Burim Shehu .....,
16. Naim Beça .....,
17. Raif Kasa .....,
18. Ernesta Krasniqi.....,
19. Bashkim Luma .....,
20. Arta Avdiu .....,
21. Ardita Rrahmani .....,
22. Besnik Salihu .....,
23. Betim Shala.....,
24. Arlinda Rakoci-Raka.....,
25. Rabije Sallahi.....,
26. Ekrem Livoreka.....,
27. Agim Çaka.....,



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kaçanik  
Municipal of Kaçanik

01Nr. 60/03-14299/24  
Kaçanik, 31.07.2024

## PROCESVERBAL

Nga Vazhdimi i dytë i mbledhjes së VI (gjashtë) të rregullt të Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2024 (Legjislatura e shtatë) të datës 28.06.2024. Mbledhja i vazhdoi punimet me datën 31.07.2024 në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, në ora 10:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës prej 27 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje fillimisht ishin 18 anëtarë. Në ndërkohë arriti edhe anëtari Besnik Salihu. Në mbledhje munguan: 8 anëtarët nga LVV (Agim Mani, Kadrije Lika-Troni, Burim Shehu, Naim Beça, Raif Kasa, Ernesta Krasniqi, Bashkim Luma, Arta Avdiu).

Nga Ekzekutivit i Komunës ishin prezentë: Kryetari i Komunës – Besim Ilazi, Nënkryetari i Komunës – Sabedin Vishi, Drejtorët e drejtorive: Qamil Stagova – DUKMM, Suhad Dullovi – DBPZHR, Ramadush Osmani – DSHPE, Sali Malsiu – DSHMS, Zahir Doda – DA, Hafize Sallahi – DKRS, Dardana Tafili – Dauti – DAP, ndërkaq nga zyrtarët: Bejtulla Dalloshi, Makfire Malsiu, Mavije Murseli.

Nga strukturat vendore mbledhja monitorohet përmes Teleprezencës nga Vjosa Ahmetaj – zyrtare në MAPL. Vazhdimi i mbledhjes ka transmetim të drejtpërdrejtë.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Murseli – Kryesues i Kuvendit  
Procesmbajtës, Makfire Malsiu – Zyrtare e lartë për punë të KK.

**Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Murseli:** Të nderuar pjesëmarrës, së pari iu përshëndes të gjithëve, iu dëshiroj mirëseardhje, konstatoj kuorumin, kushte pune ka, vazhdojmë me punimet e mbledhjes së VI (gjashtë) të rregullt të Kuvendit të Komunës të datës 28.06.2024, e cila mbledhje u ndërpre në pikët e fundit në mungesë të kuorumit. Kjo mbledhje i vazhdoi punimet me 03.07.2024, dhe e njëjta përsëri u ndërpre në mungesë të kuorumit.

Vazhdimi i dytë i mbledhjes së 6 të rregullt, me 31.07.2024, me pikat e rendit të punës si vijon:

13. Rekomandimi i komisionit vlerësues 01Nr. 104/02-11401/24 -për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës për 99 vite, në Zonën Kadastrale Koxhaj, ofertuesit X Pro Inovation LLC;
- 14 Rekomandimi i komisionit vlerësues 01Nr. 104/02-11400/24 -për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës për 99 vite, në Zonën Kadastrale Koxhaj, ofertuesit Suad Koxha;
- 15.Rekomandimi i komisionit vlerësues 01Nr. 104/02-11403/24 -për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës për 99 vite, në Zonën Kadastrale Kotlinë, ofertuesit ECO-EXCLUSIV Sh.P.K.

Në vazhdim Kryesuesi i Kuvendit –Kemal Murseli, e njoftoj KK se kam kërkuar interpretim ligjor nga MAPL, për çështjen e kthimit në rivotim të pikave 13 dhe 14, nuk kemi marrë ende ndonjë konfirmim nga MAPL. Afati ligjor i shqyrtimit të kërkesës është edhe nja 3-4 ditë. Në KPF u pajtuam që pikët 13 dhe 14 të bartën për mbledhjen e rregullt të muajit shtator. Besoj edhe atëherë na vjen konfirmimi ligjor nga MAPL. Vazhdojmë me pikën e 15, e cila pikë nuk është trajtuar ende në asnjë mbledhje.

E hapi diskutimin:

**z. Rrustem Zenuni:** Në emër të grupit të PDK, pajtohem që pika 13 dhe 14 të bartën për mbledhjen e rregullt të muajit shtator, ndërkaq pika 15 të trajtohet tani.

**znj. Ardita Rrahmani:** Nuk e di si vjen konfirmimi i ligjshmërisë nga MAPL, ndërkaq kërkoj që pikat 13 dhe 14 të trajtohen në mbledhje të rregullt të muajit shtator, e jo me herët.

**z. Agim Çaka:** Nuk e di si është marrë vendimi në KPF, a ka pasur mundësi krejt pikat me u shtyrë për mbledhjen e muajit shtator, se nuk e di a është e drejtë me u bartë vetëm pikat 13 dhe 14?

**Kryesuesi i Kuvendit:** Për pikat 13 dhe 14 kemi pasur debat dhe u kthyen në rivotim dhe kjo çështje u kontestua nga disa anëtarë të KK. Unë iu kam drejtuar MAPL me një shkresë, se a kemi të drejtë me i kthyer këto pikë në rivotim. Meqë nuk kemi ende konfirmim zyrtar nga MAPL, ndërkaq në KPF u propozua që të bartën për mbledhjen e shtatorit si pika të rregullta. Në KPF nuk është marrë vendim, vendimi merret tani në KK, e të vazhdojmë me pikën 15, të mbyllim mbledhjen e 6 të rregullt të KK. A jeni që propozim që ka dalë nga KPF, që pikët 13 dhe 14 të bartën për mbledhjen e shtatorit? Për ish-in 18 votë, Kundër votë nuk pati, Abstenoj Agim Çaka. Prezentë 19. Në saje të kësaj del konstatimi së pikët 13 dhe 14 të mbledhjes së 6 të rregullt të datës 28.06.2024, të bartën për shqyrtim në mbledhjen e muajit shtator.

Kalojmë në pikën 15:

15.Rekomandimi i komisionit vlerësues 01Nr. 104/02-11403/24 -për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës për 99 vite, në Zonën Kadastrale Kotlinë, ofertuesit ECO-EXCLUSIV Sh.P.K;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Drejtori është këtu dhe anëtarët e komisionit janë këtu, hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë këtë pikë e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua me 18 votë Për, Kundër votë nuk ka, Abstenoj Agim Çaka. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i komunës mori këtë:

#### VENDIM

**Për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për nëntëdhjetenëntë (99) vjet pronën e paluajtshme të komunës së Kaçanikut në Zonën Kadastrale Kotlinë të Kaçanikut, përmes shprehjes së interesit, kompanisë, ECO-EXCLUSIV Sh.P.K. me seli në Prishtinë, rruga:” Muharrem Fejza, përfaqësues i biznesit Leonora Morel / Lënda: 01Nr.01- 104/02-11403/24.**

Mbledhja e 6 i përfundoj punimet në ora 10:15. Deri në fund të mbledhjes ish-in 19 anëtarët që ish-in prezentë.

Mbledhja e 7 e rregullt e Kuvendit të Komunës, mbahet pas kësaj mbledhje, në ora 11:00.

Procesmbajtës  
Makfire Malsiu

*Malsiu*



**REGJISTËR I ANTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS**  
**(të zgjedhur në votimet e datës 17 Tetorit 2021);**

**Nga Mbledhja e VI (gjashtë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës për vitin 2024 e datës 28.06.2024 -Vazhdimi i dytë i mbledhjes, 31.07.2024**

1. Kemal Murseli .....,
2. Brahim Imishti.....,
3. Hamide Luma .....,
4. Kadri Krivenjeva .....,
5. Lirije Dema.....,
6. Rrustem Zenuni.....,
7. Edon Baftiu .....,
8. Selajdin Troni .....,
9. Fatmir Bunjaku .....,
10. Bashkim Krasniqi .....,
11. Florina Lika-Vishi .....,
12. Lejla Muhaxheri-Çaka.....,
13. Agim Mani .....,
14. Kadrije Lika-Troni .....,
15. Burim Shehu .....,
16. Naim Beça .....,
17. Raif Kasa .....,
18. Ernesta Krasniqi.....,
19. Bashkim Luma .....,
20. Arta Avdiu .....,
21. Ardita Rrahmani .....,
22. Besnik Salihu .....,
23. Betim Shala,.....,
24. Arlinda Rakoci-Raka.....,
25. Rabije Sallahi.....,
26. Ekrem Livoreka.....,
27. Agim Çaka.....,



## Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave

Kaçanik, 25.06.2024

**Për:** Anëtarët e Kuvendit- **znj. Ardita Rrahmani**  
**z. Naim Beça**  
**z. Ekrem Livoreka**

### Lënda: PËRGJIGJE

Të nderuar,

Më lejoni t'ju përgjigjem dhe të japim sqarime zyrtare lidhur me pyetjet/kërkesat tuaja, të parashtruara në mbledhjen Kuvendit të Komunës, më datë, **31.05.2024**, të cilat ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencave.

**znj. Ardita Rrahmani:** 1. Nga kontaktet e mia me qytetarë, i paraqes disa kërkesa dhe shqetësime të tyre. Nevoja për rrugë të reja po rritet, ndërkaq buxheti i komunës është i kufizuar, detyrimisht duhen memorandume mirëkuptimi në mes komunës dhe ministrive përkatëse-MMPHI. Ku jemi ne si komunë dhe a kemi ndonjë memorandum bashkëpunimi me atë ministri, nëse po, cilat janë ato projekte të cilat përkrahen?

- *Komuna e Kaçanikut ka Memorandum të Mirëkuptimit me MMPHI-në nga viti 2023 për bashkfinancim në realizimin e projektit të emërtuar “ Ndërtim i rrugës që lidhë pjesën jugore të Kaçanikut me rrugën Nacionale N2, (rruga “Idriz Seferi”). Ju informojmë se, përkundër kërkesave të vazhdueshme të adresuara me kohë, nga kjo ministri nuk kemi ndonjë Memorandum të ri për financim të projekteve kapitale në komunën e Kaçanikut.*

2. Çka po ndodhë me kubëzat në lagjen: “Ismail Qemali”?

- *Komuna e Kaçanikut ka të kontraktuar kompaninë për mirëmbajtjen verore dhe dimërore të rrugëve lokale. Intervenimet në rrugët lokale do të kryhen bazuar në nevojat e paraqitura në teren në çdo periudhë kohore gjatë tërë vitit (sanimin e gropave me shtresë asfalti, kubëza betoni, kalldërm, etj.)*

**z.Naim Beça:** Muajin që e lamë pas, e kemi parë një fuqi t 'vogël të natyrës se çka mundet me na bërë. Fjalën e kam për reshjet e fundit atmosferike në komunën tonë, të cilat kanë pasuar me dëme të konsiderueshme. Kjo na tregon se duhet të jemi me tepër të përgatitur për ngjarje të tilla të kësaj natyre. Në urën e Rakocit, ka intervenuar policia atje lartë, për arsye të reshjeve, se ka pasur rrezik të jetës të familjet në atë pjesë. Kërkoj të merren masa për mbrojtjen e atyre familjeve që jetojnë atje lartë dhe që paguajnë taksa, që të rregullohet shtrati i përroit të Rakocit.

- *Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave në bashkëpunim me drejtorinë përkatëse, duke ju referuar edhe Planit komunal mbi Vlerësimin e Rrezikut, ka bërë investime të vazhdueshme në rregullimin e shtretërve të përrockave të cilat kanë ndikuar dukshëm në preventimin e mundësisë së vërshimeve në komunën tonë. Edhe në rastin konkret të potencuar nga ana juaj, Sektori i Emergjencave ka dal në vendngjarje dhe ka analizuar gjendjen ekzistuese të shtratit të përroit. Në këtë rast në bashkërendim me DUKMM-në, do të shqyrtohet mundësia buxhetore për rregullim të shtratit të përroit të Rakocit edhe në lokacionin afër shtëpive që aktualisht janë ndërtuar shumë afër shtratit të këtij përroi.*



**z.Ekrem Livoreka:** Pyetje për DSHPE: Kur do të filloj implementimin i projektit, faza e II e ujësjellësit në f. Ivajë, se me të vërtetë është stërzgatur kjo çështje?

- *Shkaku i buxhetit komunal të kufizuar, projekti “Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Ivajë” është duke u implemetuar në faza. Në vitin 2022 nga buxheti komunal është ndërtuar rezervuari me kapacitet 250m<sup>3</sup> dhe në vitin 2023 është shtrirë rrjeti primar i ujësjellësit në gjatësi 6km.*
- *Këtë vit, përmes kodit “Ndërtimi i rrrjeteve të ujësjellësit”, do të vazhdohet me fazën e III-të, ku do të bëhet rrjeti i furnizimit me ujë i rezervuarit dhe shtrirja e rrjetit sekondar sipas projektit detal.*

Ju falenderojmë për bashkëpunimin tuaj!  
Me respekt,



Ramādush Osmani

-----  
Drejtor i DSHPE-s



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna Kaçanik  
Opština Kaçanik  
Municipality of Kaçanik

25.06.2024

### Përgjigje në pyetjet e Asambleistëve të Kuvendit Komunal

Pyetja nr. 2 e asambleistes znj. **Ardita Rrahmani** në lidhje me atë se a ka bazë ligjore neni 18 I ligjit për ndërtim ku përcaktohen kushtet ndërtimore.

Neni 18 I ligjit për ndërtim mund të përdoret në disa raste, jemi duke e analizuar se ku mund ta përdorim në zonën urbane të Kaçanikut. Sipas neni 18 mund të përdoren kushtet ndërtimore të njejtë sikurse kushtet ndërtimore të objekteve të ndërtuara me leje ndërtimore në distancë 50 metra.

Pyetja nr. 4 e asambleistes znj. **Ardita Rrahmani** në lidhje me atë se kur do të jetë në shërbim të qytetarëve ura te ETC-ja dhe ku kanë ngelur punimet te nënkalimi.

Të dy këto projekte pritet të përfundojnë brenda këtij viti.

Pyetje nga asambleisiti **z. Naim Beqa** në lidhje me atë se sa projekte janë nisur në Komunën tonë qe një kohë të gjatë dhe nuk janë realizuar. Këtu hyn projekti rregullimi dhe asfaltimi I Rrugës "Avdurrahim Shehu", në Kaçanik, fjala është për zhvendosjen e disa shtyllave elektrike. Po ashtu, edhe trotuari ka mbetur I papërfunduar në një pjesë të rrugës në gjatësi 50 m', planifikojmë që këto punë të përfundohen brenda këtij viti.

Drejtori i DUKMM-se  
Qamil Stagova



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kaçanik  
Municipality of Kaçanik

## DREJTORIA E ARSIMIT

**Përgjigje në pyetjen e znj. Ardita Rrahmani:** Nuk është hera e parë që flas në këtë KK as nuk do të jetë hera e fundit, derisa të shoh fillimin e punimeve në shkollën "Emin Duraku". Jemi gati në përfundim të vitit shkollor, ndërkaq nxënës, prindër dhe arsimtarë, po prekën me së shumti. Çka ka konkrete rreth asaj shkolle, ku jemi me letra?

**Përgjigje:** Pas disa kërkesave të njëpasnjëshme që pesë vite me radhë, për ndërtimin e objektit të ShFMU "Emin Duraku" në Kaçanik është zotuar MASHTI dhe ka premtuar që këtë vit do të fillojnë punimet. Në janar të vitit 2024 MASHTI ka publikuar njoftimin që në qershor të këtij viti do të publikohet tenderi për ndërtimin e ShFMU "Emin Duraku" në Kaçanik. Çdo kërkesë e drejtuar në DKA nga MASHTI dhe Kompania e kontraktuar për hartim të projektit, është shqyrtuar në afat rekord dhe jemi përgjigjur pozitivisht. Sipas përgjigjeve që marrim nga MASHTI, pritet që shumë shpejt të bëhet publikimi i tenderit.

P.S. Përgjigjes po i bashkangjes edhe komunikimin e fundit trepalësh: MASHTI-DKA-Kompania projektuese të datës 18.06.2024 ku shihet qartë kërkesa urgjente për përfundim të projektit dhe publikim të tenderit.

Me respect,  
Drejtori: Zahir Doda

## Zahir Doda

---

**From:** Besim Muharremi  
**Sent:** Tuesday, June 18, 2024 1:52 PM  
**To:** Blerim ÇEKU; ALB Architect  
**Cc:** Fadile Dyla; Xheneta Bajrami; Zahir Doda  
**Subject:** Noftim

Përsëndetje,

Bazuar ne shkresën tuaj te dt. 13.06.2024 (përmes emalit), ku keni sqaruar qëndrimet e DKA-së se Kaçanikut si dhe duke ju referuar shkresës se drejtorit te DKA-së, Kaçanik dt. 18.06.2024 për çështjen e përpilimit te projektit për SHFMU “ Emin Duraku” në Kaçanik, si ne vazhdim:

Përsëndetje z. Muharremi,

**Në SHFMU “Emin Duraku” në Kaçanik janë 896 nxënës dhe 152 parashkollor që gjithsej janë 1048 fëmijë. Meqë shkolla gjendet në zonën urbane (në qytetin e Kaçanikut) dhe numri I fëmijëve edhe në të ardhmen vetëm mund të rritet, kemi kërkuar që objekti shkollor t'i plotësojë standardet për këtë numër të nxënësve. Tereni ku gjendet parcela e destinuar për ndërtimin e objektit shkollor, nuk ka hapësirë për shtrirje horizontale, prandaj si DKA pajtohem që ndërtimi I objektit t'i plotësojë kriteret për numrin e nxënësve edhe nëse ka devijime të vogla në Project bazuar në etazhitet. Zgjidhja e ofruar nga kompania projektuese: Bodrumi, sutereni, përdhese dhe dy kate, I plotësona kriteret për numrin e nxënësve dhe përshtatet me terrenin.**

Prandaj, duke pasur ne konsideratë krijimin e hapësirave për mësimdhënie dhe mësim nxënie sa me komode për nxënësit , kërkohe nga ju qe te vazhdoni me projekt sipas kushteve urbanistike te lëshuara nga komuna e Kaçanikut përkundër qe udhëzimi për ndërtimin e SHMU determinon standard tjetër ne kuptimin e etazhi tetit, por me rekomandim qete shtohet edhe një ashensor Brenda hapësirës se komunikimit te nxënësve.

Ky pëlqim I yni bëhet me te vetmin qëllim qe te kemi hapsin te mjaftueshme për nxënësit e atij lokaliteti duke pasur ne konsideratë referimin e drejtorit te DKA-së në Kaçanik z. Doda.

**PS. Kërkohe nga ju qe projekti te jetë I gatshëm ne Kohen sa me te shkurtër qe te procedohet për tenderim.**

**Besim Muharremi**

Shef i Divizionit për Zbatimin e Projekteve

Departamenti për Integritim Evropiane, Koordinim të Politikave dhe Çështje Ligjore

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit

Republika e Kosovës

**e-mail: [besim.muharremi@rks-gov.net](mailto:besim.muharremi@rks-gov.net)**

tel: 038 211 021, ext 20 035

mob: +383 44 179 339

---

**From:** Blerim ÇEKU [mailto:archblerimceku@gmail.com]

**Sent:** Thursday, June 13, 2024 3:06 PM

**To:** Besim Muharremi <Besim.Muharremi@rks-gov.net>

**Cc:** Afrim Demiri <afrimdemiri@albarchitect.com>; ALB Architect <info@albarchitect.com>; Fadile Dyla <Fadile.Dyla@rks-gov.net>; Xheneta Bajrami <Xheneta.Bajrami@rks-gov.net>

**Subject:** Re: PER TE JU RIKUJTUAR- APROVIMI I PROJEKTIT IDEOR- SHKOLLA FILLORE E MESME E ULET KAÇANIK



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



**Komuna e Kaçanikut**  
Opština Kacanik  
Municipal Kacanik

**Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale**  
Kaçanik, 26.06.2024

Lënda : **Përgjigje lidhur me pyetjen e z.Agim Çaka, në mbledhjen e Kuvendit të Komunës , të datës 31.05.2024.**

**Agim Çaka-** Një raport i cili është kërkuar për objektin social, pyetja ka qenë konkrete: Cilat kanë qenë parashikimet apo planifikimet lidhur me shpenzimet do të krijohen me përfundimin e atij objekti? Sa ka ndihmuar qeveria, sa ka dhënë mjete komuna, sa kemi dalë jashtë parashikimeve me dhënien e mjeteve, për atë objekt dhe a është në përfundim ai objekt apo ka mundësi që ai objekt deri në përfundim të kalojë 2 legjislatura të KK ? Kjo problematikë është diskutuar edhe në legjislaturën e kaluar, po diskutohet edhe në këtë legjislaturë, kështu që është mirë me na treguar: Sa ka kushtuar në total objekti dhe sa ka dalë jashtë parashikimeve të planifikuara?

**Përgjigje-** I nderuar, ndërtimi i objektit të banimit social ka filluar në vitin 2017 dhe ka përfunduar në vitin 2023. Është bërë pranimi teknik i objektit dhe jemi duke filluar procedurat për ndarjen e banesave. Kontrata bazë për ndërtimin e këtij objekti, e datës 27.07.2017, ka qenë 343,974.19 €, puna shtesë për fazën e parë ka kushtuar 34,397.19 €, ndërsa faza e dytë ka kushtuar 78,515.50 €, që në total ka kushtuar 456,886.88 €.

Drejtori i DSHMS  
Sali Malsiu